

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5924
E enjte, 7 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Shpend Maxhuni jep dorëheqje nga pozita e drejtorit të AKI-së | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATON ABDULLAHU | FAQE 4-5



POSTI I PRESIDENTIT KOMPLIKON NEGOCIATAT LV - LDK PËR FORMIMIN E QEVERISË

Analisti politik Faton Abdullahu ka vlerësuar se moscertifikimi i zgjedhjeve të 6 tetorit nuk duhet të jetë kurrfarë justifikimi për të mos e shpejtuar procesin e bisedimeve për krijimin e qeverisë së re. Ai ka thënë se karta e re për postin e presidentit i komplikon

negociatat në mes të LV-së dhe LDK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se nuk po merret parasysh sugjerimi i partnerëve tanë ndërkombëtarë, se qeveria duhet të krijohet sa më shpejt, të pezullohet taksa dhe menjëherë të rifillojë dialogu

me Serbinë. Megjithatë, edhe nëse formohet qeveria me koalicionin LV - LDK, Abdullahu ka shprehur skepticizëm për funksionimin e saj për shkak të dallimeve parimore, ideologjike dhe strategjike që kanë këto dy subjekte politike

KQZ-ja: Nëse nuk ka ankesa, rezultatet përfundimtare shpallen sot



Nëse nuk do të ketë ankesa, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) sot (e enjte) do t'i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit. Kështu ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Ai ka treguar se Ligji për zgjedhjet e përgjithshme e lejon mundësinë e ankesave brenda 24 orëve në PZAP lidhur me administrimin e numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Sipas Elezit, KQZ-ja do të komunikojë me institucionet përkatëse për të marrë konfirmim se nuk kanë ndonjë çështje në shqyrtim, pastaj do të mund t'i shpallë rezultatet përfundimtare | FAQE 3

IKD-ja:
Këshilli
Gjyqësor dhe
Këshilli
Prokurorial
përballen me
joefikasitet

FAQE 7

OPINION

FALSIFIKIMI I RAPORTIT TË EKSPERTIZËS ZVICERANE PËR RASTIN 'ASTRIT DEHARI' NË FUNKSION TË FSHEHJES SË KRIMIT F. 10-11

Shkruan: Bardhyl MAHMUTI



ARTA DHE JETA F. 13

Nga: Elife PODVORICA

AKTUALE

SHQIPËRIA DO TA NDIHMOJË FINANCIARISHT LUGINËN PËR BLERJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE F. 2

RRITET NUMRI I BRAKTISJES SË FOSHNJAVE NË OKUK F. 3

EKONOMI

TAKSA E LË PA PARA FONDIN PËR ZHVILLIMIN E VERIUT F. 8

KËRKOHEM QË OSHP-ja TA RRIJË KONSISTENCËN NË VENDIMARRJE F. 8

SPORT

FERONIKELI TRIUMFON NDAJ PRISHTINËS, BALLKANI NDALET NGA LLAPI F. 16

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Osmani njofton zyrtarët e BE-së për formimin e qeverisë së re

PRISHINË, 7 NËNTOR - Nënkrjetarja e Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, ka zhvilluar vizitë zyrtare në Bruksel me ftesë të komisionarit për zgjerim, Johannes Hahn. Përveç takimit me komisionarin Hahn, Osmani ka zhvilluar takime edhe në Parlamentin Evropian, ku është pritur nga zëvendëspresidenti i këtij institucioni, Rainer

Wieland, kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, David McCallister, eurodeputetët Lucas Mandl dhe Andrew Kovachev si dhe sekretari për Marrëdhënie me Jashtë në Partinë Popullore Evropian (EPP), Patrick Voller.

Nënkrjetarja Osmani ka zhvilluar takime edhe në Shërbimin e Jashtëm të Bashkimit Evropian (EEAS) ku është pritur nga sekre-

tarja e përgjithshme Helga Schmidt dhe nga drejtoresha për Evropë në këtë shërbim, Angelina Eichhorst.

Në këto takime, nënkrjetarja Osmani ka diskutuar lidhur me zgjedhjet e fundit të mbajtura në Kosovë, të ariturat dhe sfidat gjatë këtij procesi si dhe diskutimet aktuale rreth formimit të Qeverisë së re.

Gjatë takimeve është diskutuar tema e dialogut Kosovë-Serbi, përpjekjet e Kosovës për fuqizimin e subjektivitetit të saj ndërkombëtar si dhe reformat e nevojshme për proceset integruese për Republikën e Kosovës.

Me këtë rast, Osmani ka ritheksuar se liberalizimi i vizave ka mbetur zotim i papërbushur i BE-së karshi qytetarëve të Kosovës.



Liderët e Ballkanit të shtunën në samitin e Ohrit

Tre liderët që kanë ngritur idenë e "Shengenit të Ballkanit", kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe presidenti serb, Aleksandar Vuçiq të shtunën do të marrin pjesë në samitin e Ohrit për zbatimin e katër lirive të Bashkimit Evropian



TIRANË, 7 NËNTOR - Ashtu siç ishte përcaktuar, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama do të udhëtojë për në Ohër, ku do të marrë pjesë në samitin për zbatimin e katër lirive të Bashkimit Evropian. Siç ka njoftuar zyra e shtypit e Kryeministrit, kreu i qeverisë do të jetë i pranishëm në darkën e shtruar me këtë rast nga presidenti i Maqedonisë Veriore Stevo Pendarovski. Ndërkohë, të dielën do të mbahet Samiti, i cili do të pasohet nga konferenca për shtyp në

orën 12.00. Kujtojmë se në samit do të marrin pjesë edhe kryeministri në detyrë i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev dhe presidenti serb Aleksandar Vuçiq. Ky i fundit konfirmoi praninë e tij në samit pas një telefonate që kishte bërë me Ramën dhe kryeministrin ende në detyrë të Maqedonisë, Zoran Zaev. Të tre këta lider kanë ngritur idenë e krijimit të 'Shengenit të Ballkanit'. Ndërkaq, presidenti i Serbisë Aleksander Vuçiq në një inter-

vistë për mediet serbe, e konsideron dialogun e ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara si themelin e bashkëpunimit ekonomik në rajon. Vuçiqi është ndalur edhe tek iniciativa për krijimin e "Shengenit ballkanik" dhe te takimi i radhës që do të ketë në

Ohër me kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama dhe atë të Maqedonisë së Veriut Zoran Zaev. "Përfaqësuesi Special për dialogun Kosovë-Serbi Richard Grenell ka një energji të jashtëzakonshme dhe ka ide për ngritjen e gjendjes ekonomike

në të gjithë Ballkanin. Një gjë e tillë mund të jetë një bazë për negociata shumë më serioze edhe për marrëveshje. Ndaj është e rëndësishme që të bisedoj me Edi Ramën dhe Zoran Zaevin, në mënyrë që të krijojnë raporte sa më të mira në rajon", është shprehur Vuçiqi.

Dënohen me burgim dy nga gjashtë shtetasit turq që u dëbuan nga Kosova



ANKARA, 7 NËNTOR - Gjykata turke ka dënuar me nga shtatë vjet e gjashtë muaj burgim dy nga gjashtë pjesëtarët e të ashtuquajturës organizatë terroriste FETO, të cilët ishin sjellë në Turqi nga Kosova vitin e kaluar përmes një operacioni të Agjencisë Kombëtare Turke të Inteligjencës (MIT) në bashkëpunim me inteligjencën e Kosovës, raporton "Anadolu Agency (AA)". Në seancën e mbajtur në

Gjykatën e 30-të të Krimeve të Rënda në Stambollit, Osman Karakaya dhe Cihan Ozkan kanë mohuar akuzat e ngritura ndaj tyre. Trupi gjykoës i ka liruar të pandehurit Karakaya dhe Ozkan nga akuza për "spiunazh ndërkombëtar", por ka shpallur dënim me nga shtatë vjet e gjashtë muaj për akuzën "pjesëmarrje në organizatë të armatosur terroriste". Në aktakuzën e përgatitur nga

Prokuroria Republikane e Stambollit, gjashtë të dyshuarit, ndër të tjera, ngarkoheshin me akuzat "drejtim i një organizate terroriste të armatosur" dhe "spiunim ndërkombëtar" dhe për ta ishte kërkuar burgim nga 16 vite e gjashtë muaj deri në 28 vjet. Gjykata e Krimeve të Rënda e Stambollit kishte ndarë lëndën për Osman Karakaya dhe Cihan Ozkan.

Shqipëria do ta ndihmojë financiarisht Luginën për blerjen e teksteve shkollorë

TIRANË, 6 NËNTOR - Ministri i Jashtëm në detyrë i Shqipërisë, Gent Cakaj, ka njoftuar se Këshilli i Ministrave të Shqipërisë ka vendosur dhënie të një mbështetjeje shtesë financiare për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Luginë të Preshevës me qëllim të blerjes së

teksteve shkollorë. Lajmin Cakaj e ka bërë me dije në llogarinë e vet në "Facebook". "Edhe një informacion tepër i vyer e shumë domethënës për Shqipërinë dhe shqiptarët. Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë sot ka vendosur dhënie të një mbështet-

jeje shtesë financiare për Këshillin Kombëtar në Serbi me qëllim blerjen e teksteve shkollorë. Ky vendim u shërben nxënësve shqiptarë që ndjekin procesin mësimor në institucionet e sistemit parauniversitar në tri komuna: Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje. Ky

vendim është në funksion të rritjes së edukimit në përgjithësi dhe ruajtjes së identitetit kombëtar në veçanti. Shqipëria mbetet e përkushtuar për rritjen e kujdesit për të gjithë shqiptarët në rajon dhe diasporë në përgjithësi", ka shkruar Cakaj.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka paralajmëruar shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit

KQZ-ja: Nëse nuk ka ankesa, rezultatet përfundimtare shpallen sot

Nëse nuk do të ketë ankesa, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) sot (e enjte) do t'i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 6 tetorit. Kështu ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Ai ka treguar se Ligji për zgjedhjet e përgjithshme e lejon mundësinë e ankesave brenda 24 orëve në PZAP lidhur me administrimin e numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Sipas Elezit, KQZ-ja do të komunikojë me institucionet përkatëse për të marrë konfirmim se nuk kanë ndonjë çështje në shqyrtim, pastaj do të mund t'i shpallë rezultatet përfundimtare



EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

PRISHTINE, 6 NËNTOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka paralajmëruar se rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit do të shpallen sot (e enjten) nëse nuk do të ketë ankesa brenda afatit ligjor.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka treguar se Ligji për zgjedhjet e përgjithshme e lejon mundësinë që të bëhet ankesë brenda 24 orëve në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia lidhur me administrimin e numërimit në

Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Ai ka bërë me dije se KQZ-ja është e obliguar ta respektojë këtë afat ligjor. "Ligji për zgjedhjet e përgjithshme e lejon mundësinë që të bëhet ankesë brenda 24 orëve në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia lidhur me administrimin e numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Prandaj, duke e ditur se të martën rreth mesnatës është përmbyllur procesi i numërimit të fletëvotimeve sipas vendimit të Gjykatës Supreme, KQZ-ja është e obliguar ta respektojë këtë afat ligjor. Ashtu siç ju kemi informuar,

KQZ-ja do të komunikojë me institucionet përkatëse për të marrë konfirmim se nuk kanë ndonjë çështje në shqyrtim dhe pastaj do të mund t'i shpallë rezultatet përfundimtare të këtyre zgjedhjeve. Nëse nuk do të ketë ankesa brenda këtij afati, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do t'i shpallë rezultatet përfundimtare gjatë ditës së enjte (7 nëntor) - ka thënë Elezi për gazetën "Epoka e re". Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë janë mbajtur më 6 tetor. Bazuar në raportimet nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë, procesi zgjedhor ka qenë i qetë

dhe në përputhje me standardet demokratike. Vonesat për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit kanë ardhur si rezultat i ankesave të njëpasnjëshme për rinumërimin e mbi 800 vendvotimeve. Po ashtu, problem kanë paraqitur edhe votat e ardhura në zarfe nga Serbia, të cilat kanë marrë disa ditë kohë për t'u verifikuar. Fillimisht hapja e tyre ka dhënë pasojë, ku dhjetëra punonjës të Qendrës së Numërimit dhe Rezultatit (QNR) janë helmuar nga kontakti me këto zarfe, të cilët janë trajtuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës

(QKUK). Gjithashtu, vonesa kanë krijuar edhe mbi 4 000 vota të ardhura me vonesë nga diaspora për të cilat është dashur të merren dy vendime nga Gjykata Supreme dhe një nga PZAP-i. Ndërkaq sipas rezultateve preliminare të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje (LV) është fituese e zgjedhjeve të 6 tetorit, kurse në vendin e dytë është renditur Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e treta ka dalë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e ndjekur nga koalicioni AAK-PSD, kurse koalicioni Nisma-AKR-PD është duke luftuar për ta kaluar pragun zgjedhor.

Rritet numri i braktisjes së foshnjave në QKUK

PRISHTINE, 6 NËNTOR - Gjatë dhjetë muajve të parë të këtij viti në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës janë braktisur 38 foshnja. Ndërkohë, 26 prej tyre janë bashkuar me njërin apo dy prindërit biologjikë, pas bisedave të shumta në mes të prindërve me punëtorët shëndetësorë, por edhe psikologët.

Dymbëdhjetë foshnja kishin mbetur në Klinikën e Neonatologjisë, prej nga dhjetë prej tyre u ishte siguruar një "shtëpi e re" për të jetuar përmes një programi të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kurse dy foshnja janë ende në QKUK.

Në mungesë të nënës, foshnjave përfaqësimin e parë pas braktisjes ua jep infermierja Gjyle Fejzullahu, e cila tash e 34 vjet punon në Repartin e Fëmijëve të Braktisur. Ajo thotë për "Radion Evropa e Lirë" se shpeshherë nënat që vendosin t'i braktisin foshnjat e tyre nuk dëshirojnë t'i shohin ato. Andaj, kontaktin e parë këta fëmijë e kanë me infer-

mieret, e që për to është një përjetim i veçantë, por edhe i dhimbshëm. "Unë i dua këto foshnja. Kam lidhje shpirtërore me to. Kontaktin e parë e kanë me ne, infermieret. Ne i lajmë, i pastrojmë, i ushqejmë, i duam shumë. Kur shkojnë prej klinikës, ne mërzmitemi shumë sepse po lidhemi emocionalisht me këta fëmijë. Ndiej edhe dhembshuri për to sepse, në shumicën e rasteve, nënat që i braktisin nuk dëshirojnë t'i shohin fare", ka thënë Fejzullahu.

Xhevdet Gojnovci, drejtor i Klinikës së Neonatologjisë, që funksionon në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, tha se aktualisht në klinikë janë dy foshnja të braktisura, që janë nën kujdesje të stafit, kurse të tjerët janë dërguar në Departamentin e Mirëqenies Sociale, si dhe 26 të tjerë që tashmë janë bashkuar me njërin ose të dy prindërit biologjikë.

Vitin e kaluar kanë qenë 29 raste të foshnjave të braktisura. Prej tyre, 20 fëmijë janë bashkuar me famil-



jarë, kurse nëntë raste janë marrë nga Departamenti për Mirëqenien Sociale që funksionon në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Problemi që prej vitesh po e përcjell Klinikën Neonatologjike është mungesa e stafit të mesëm, përkatësisht infermierëve. Gojnovci, duke folur për "Radion

Evropa e Lirë" tha se, ndonëse kanë kërkuar që të rritet numri i stafit, kjo ndër vite mbetet një sfidë e pazgjidhur. "Edhe më herët ne kemi bërë ankesë për numrin jo të mjaftueshëm të infermierëve. Këtë vit kemi pranuar pesë infermiere. Ende kemi nevojë për infermiere/ë të rinj. Por, foshnjat e braktisura kanë 24 orë në ditë,

shtatë ditë në javë dhe kujdesin maksimal e marrin nga infermieret ekzistuese", ka thënë Gojnovci. Një rast më i rëndë që kishte ndodhur këtë vit në këtë klinikë ishte ai i një foshnje të braktisur, e cila kishte lindur me një sëmundje. Pas një jave në kujdesin intensiv të QKUK-së, ajo kishte ndërruar jetë.

Flet për "Epokën e re", Faton Abdullahu

Posti i presidentit komplikon negocia



Analisti politik Faton Abdullahu ka vlerësuar se moscertifikimi i zgjedhjeve të 6 tetorit nuk duhet të jetë kurrfarë justifikimi për të mos e shpejtuar procesin e bisedimeve për krijimin e qeverisë së re. Ai ka thënë se karta e re për postin e presidentit i komplikon negociatat në mes të LV-së dhe LDK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se nuk po merret parasysh sugjerimi i partnerëve tanë ndërkombëtarë, se qeveria duhet të krijohet sa më shpejt, të pezullohet taksa dhe menjëherë të rifillojë dialogu me Serbinë. Megjithatë, edhe nëse formohet qeveria me koalicionin LV - LDK, Abdullahu ka shprehur skepticizëm për funksionimin e saj për shkak të dallimeve parimore, ideologjike dhe strategjike që kanë këto dy subjekte politike

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 6 NËNTOR -

"Epoka e re": Z. Abdullahu, si jeni duke i parë negociatat në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës për formimin e qeverisë së re? Do të mund të formohet ky koalicion qeverisës?

Abdullahu: Kam përshtypjen se në këtë proces nuk po merret sa duhet parasysh sugjerimi i

partnerëve tanë ndërkombëtarë i thënë pa ekuivokë, posaçërisht i ShBA-së, se qeveria duhet të krijohet sa më shpejt, të pezullohet taksa dhe menjëherë të rifillojë dialogu. Moscertifikimi i zgjedhjeve nuk duhet të jetë kurrfarë justifikimi për të mos e shpejtuar procesin e bisedave për krijimin e qeverisë së re dhe sidomos jo mosfillimin e bisedimeve gjithanshëm dhe seriozisht për çështjet vitale politike ndërmjet aktorëve

kryesorë të LV-së dhe të LDK-së. Fakti se tani kemi edhe një kartë të re të vendosur në tavolinën e negociatave për krijimin e qeverisë LV - LDK, atë të bërjes së z. Mustafa president të Kosovës, e komplikon këtë negociatë, për rrjedhojë, mbase, edhe e prolongon pajustificueshëm. Duke pasur parasysh rrethanat në të cilën gjendemi sot, ku brengosshëm na shquan shkalla më e ulët e arritur ndonjëherë në dy deka-

dat e fundit e nivelit të raporteve me partnerët ndërkombëtarë, ku s'kemi njohje të reja e po rrezikohemi me çnjohje, ku Serbia nuk perceptohet më si e 'çmendura e Ballkanit', ku BE-ja vazhdon të mos na përkëdhelë, prolongimet e mundshme për krijimin e qeverisë, për çështje se kush cilën ministri do ta ketë apo kush do të jetë kryeministër, janë moralisht të padenja e politikisht mund të jenë të dëmshme.

"Epoka e re": Duke pasur parasysh dallimet që kanë këto parti, sa do të jetë funksionale qeveria e udhëhequr nga LV - LDK? Cilat do të jenë pengesat kryesore në këtë drejtim?

Abdullahu: LV-ja dhe LDK-ja janë forca politike të cilat kanë dallime të mëdha ndërmjet vete. Për më shumë ato kanë histori edhe armiqësore jo lehtë të riparueshme. Ky realitet i hidhur ka pasur edhe segmente kriminale, prandaj natyrshëm mund ta rritë skepticizmin e atyre të cilët mund të kenë drojë se qeveria e

udhëhequr nga LV - LDK mund të mos krijohet apo, nëse krijohet, mund të kenë dyshime se barrierat në të ardhmen mund të mos tejkalohen sa e si duhet. Dallimet janë edhe parimore, edhe ideologjike, edhe strategjike. Sa për ilustrim, për ta dëshmuar këtë konstatim, po përmendi se LDK-ja asnjëherë nuk e intonon himnin kombëtar shqiptar në të gjitha tubimet e manifestimet që i organizon. E çuditshme, por e vërtetë. Kurse LV-ja asnjëherë nuk e intonon himnin e Kosovës. E pabesueshme, por reale. Për më shumë, LDK-ja rrallë e hiç e përdorë flamurin kombëtar shqiptar, kurse këtë është e bindur se e zëvendëson suksesshëm me, siç e quajnë ata, 'flamurin dardan'. Në anën tjetër, LV-ja përdorimin e flamurit të Kosovës e konsideron tradhti nacionale. Këto dallime nuk janë vetëm simbolike, as nuk janë vetëm koreografi politiko-kulturore. Ato janë dëshmi për dy subjekte me defekte të mëdha identitare. Thjesht, mjafton të vështrohet

tat LV - LDK për formimin e qeverisë

nga ky prizëm për ta kuptuar se këto dy gjysma - LV - LDK - kanë predispozita për të mos e bërë një tërësi politike funksionale dhe pragmatike për vendin tonë. Përkundër kësaj, unë konsideroj se këto dy forca politike kanë përgjegjësi para votuesve të tyre që ta krijojnë qeverinë sa më shpejt. Mendoj se LDK-ja, pos të tjerash, do ta shtyjë këtë proces përpara sepse është e vetëdijshme se duke qenë në pushtet do t'i menaxhojë më lehtë ndasitë dhe hatërmbetjet klanore përbrenda saj të cilat përndryshe mund të shkaktojnë turbulenca jo kollaj të menaxhueshme. Edhe LV-ja ka interesa vitale për ta shtyrë procesin përpara, sepse me këtë ajo dëshiron të dëshmojë se mund të ngritet në një shkallë më të lartë të veprimit e patriotizmit, atë institucionalist. Nëse kjo nuk ndodh, ajo është e vetëdijshme se akuzat se, LV-ja është parti e protestave dhe e rrugëve, mund të bëhen më bindëse e, për rrjedhojë, t'i hakmerren asaj në zgjedhjet e ardhshme.

"Epoka e re": Aktualisht po flitet për zvogëlimin e numrit të ministrive nga 22 në 12 sosh. Do të mund të realizohet një gjë e tillë. Nëse po, cilat do të jenë të mirat apo pasojat e këtij procesi?
Abdullahu: Dikur thoshin se vetëm Kina ka një ministri më shumë se Kosova për të treguar se sa absurd ishte numri kaq i madh i ministrive në qeveritë e kaluara. Realisht, numri ekzistues i ministrive është i madh dhe duhet të zvogëlohet, por parimisht 12 ministri nuk

janë në asnjë variant garanci se do të jenë funksionale dhe të dobishëm. Mund të kemi ministri në numër sa Gjermania e Franca, por të bëjmë gabime të mëdha sa Kina. Thjesht, kjo zhurmë për këtë reduktim buron nga mendësia e përpunuar populiste, ku më pak mund ka përpjekje të arrihet perceptimi se po bëhet shumë. Mbetet të shihet e të vlerësohen më pas performancat e ministrive që do të mbeten.

"Epoka e re": Si e komentoni në përgjithësi procesin dhe rezultatin zgjedhor i cili, si duket, ka lënë jashtë Kuvendit disa parti! Meqenëse keni qenë pjesë e qeverisë Mustafa dhe njihni nga afër funksionimin e LDK-së, cilat mendoni se kanë qenë arsyet që kjo parti nuk i fitoi zgjedhjet?

Abdullahu: LDK-ja ka dalë në zgjedhje edhe pa u reformuar edhe me kuadro të vjetra. Me zgjedhjet e brendshme e ka konfirmuar këtë. Por ajo ka përdorur një truk politik para votuesve dhe simpatizantëve të vet. LDK-ja ka përdorur të gjitha simpatitë dhe votat e Vjosa Osmanit për të krijuar përshtypje se edhe ka reforma, edhe ka kuadro të reja. Thjesht, Vjosa Osmani ka qenë mashtrim optik. Dihet se ajo gjithë këtë akumulim politik e ka bërë vitet e fundit, duke kritikuar pandalshëm kryetarin, kryesinë, nënkryetarët e LDK-së, thjesht krejt konceptet dhe strategjitë e LDK-së. Pra, këtu ka pasur një diskrapancë politikisht patologjike. Vjosa Osmani është perceptuar si reformatore e LDK-së, si kuadër i ri me

mendime e koncepte të reja, e cila do ta marrë timonin e ecjes politike të LDK-së. Por, kjo nuk ka ndodhur. As nuk do të ndodhë në disa vite të ardhshme sepse zgjedhjet e brendshme kanë përfunduar. Ky është realitet në LDK të cilin ata që e kanë kuptuar kanë hezitur që këtij marifeti politik t'ia japin votën për ndryshime.

"Epoma e re": Sfida kryesore në aspektin e jashtëm për qeverinë e re do të jetë dialogu me Serbinë. A prisni finalizim të suksesshëm të këtij procesi nën drejtimin e qeverisë Kurti?

Abdullahu: LV dhe z. Kurti kanë shprehur haptazi se nuk kanë arsye të nxitojnë për ta rifilluar dialogun me Serbinë. Ndërkohë që z. Konsnet në takimin e parë me kandidatit e LV-së për kryeministër ka theksuar që qeveria të krijohet sa më parë dhe menjëherë të rifillojë dialogu me Serbinë. Ky është mospajtimi i parë brengosës LV - ShBA. Kurse në këtë aspekt LDK-ja vazhdon të sillet thua se nuk e ka thënë në mënyrë të përsëritur këtë partneri i saj potencial në qeverinë e re. Ky inercion tradicional i LDK-së mund ta dobësojë atë para LV-së dhe të kapërdihet nga diktimi i ritmit që e dëshiron LV-ja. Mbetet të shihet se delikuenca e dikurshme antiinstitucionaliste e LV-së do të konvertohet suksesshëm për të qenë pjesë e mendësisë euroatlantike dhe demokracisë liberale evropiane. Me mirëkuptimin e tepruar që e ka LDK-ja në natyrën e saj, zor se do ta ndihmojë shumë këtë proces. Mbetet të shihet.

Shpend Maxhuni jep dorëheqje nga pozita e drejtorit të AKI-së

PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER) - Shpend Maxhuni ka dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit të Agjencisë të Kosovës për Inteligjencë (AKI). Lajmin e ka bërë me dije të mërkurën, përmes llogarisë së vet në "Facebook", kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj. "Kam pranuar dorëheqjen e drejtorit të AKI-së, z. Shpend Maxhuni, nga funksioni i tij në krye të inteligjencës kosovare. Z. Maxhunin e falënderova për bashkëpunimin profesional të deritashëm për mbrojtjen e sigurisë së vendit dhe popullit tonë. Për kontributin e tij në obligimet shtetërore dhe institucionale e dekorova z. Maxhuni me 'Medaljen e Skënderbeut', me motivacionin për profesionalizëm dhe besnikëri në shërbim

ndaj atdheut. Gjatë këtij mandati Qeveria e Kosovës është angazhuar pa ndal për forcimin e rendit dhe ligjit në vend dhe institucionet e sigurisë. Në këtë angazhim roli i z. Maxhuni ka qenë i rëndësishëm së veçantë dhe sot AKI është një ndër institucionet më profesionale dhe më kredibile në vend dhe më gjerë", ka shkruar Haradinaj. Maxhuni ishte emëruar në këtë pozitë në prill të vitit të kaluar. Para kësaj pozite ai ka qenë drejtor i Policisë së Kosovës. Maxhuni ishte emëruar në këtë pozitë pasi Driton Gashi, drejtor i AKI-së atëbotë, kishte ofruar dorëheqjen e kërkuar nga kryeministri në largim, Haradinaj, pas dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova në Turqi.



Në Prishtinë fillon konferenca ballkanike 'Ujë për të gjithë'

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Në kryeqytet ka filluar të mërkurën punimet konferenca dhe ekspozita e shtatë e përbashkët ballkanike e cila do të zgjasë deri më 8 nëntor. Tema e kësaj konference do të jetë "Ujë për të gjithë", e cila është frymëzuar nga Dita Botërore e Ujit 2019 e OKB-së dhe përqendrohet në trajtimin e krizës së ujit duke adresuar arsyet pse kaq shumë njerëz janë lënë mbrapa. "Uji është një e drejtë njerëzore dhe askush nuk duhet lënë pa qasje ndaj ujit të sigurt. Qasja ndaj ujit forcon shëndetin publik, prandaj është kritik për zhvillimin e qëndrueshëm dhe një botë të qëndrueshme dhe të begatë. Konferenca dhe ekspozita e përbashkët ballkanike është shndërruar me të vërtetë në

ngjarjen më të madhe për ndarjen e informacionit dhe 'networking' në sektorin e ujit në Ballkanin Perëndimor", është thënë në njoftimin për media të kompanisë Rajonale të Ujësjesit "Prishtina" Sh. A. Sipas këtij njoftimi, me një audiencë mbi 500 pjesëmarrës nga rajoni i Ballkanit dhe më gjerë, konferenca vazhdon të ofrojë një platformë ku profesionistë të ujit, politikëbërës dhe profesionistë të biznesit nga sektori mund të mblidhen dhe diskutojnë mbi çështje me interes, shkëmbejnë informacion dhe ndajnë përvojat e tyre në përpjekje për ta ndihmuar më tej zhvillimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Rajonin e Ballkanit. "Si tradicionalisht, paralelisht me konferencën, Komiteti Organizativ ka planifikuar një ambient të madh për ekspozitën ku do të ekspozohen pajis-



je, teknologji dhe shërbime, nga një rrjet i gjerë kompanish të sektorit privat që janë aktive në sektorin e ujit të rajonit të Ballkanit. Uji është burim natyror shumë i nevojshëm për ekonomi dhe mirëqenien sociale. Uji në krojet tona nuk është dhuratë e natyrës, por një proces që kushton (energj,

pompa, pajisje, kimikate, gypa, derivate, fuqi punëtore, dijëni dhe investime). Menaxhimi i sistemit të ujësjesit të Prishtinës, për të pasur ujë të mjaftueshëm dhe të pastër, kushton. Secili nga ne si qytetarë të këtij vendi kemi të drejtë për qasje në ujë të pastër për pije dhe qasje në kanalizim.

Integrimi gjinor, përfshirja e femrave e domosdoshme për vlerësimin e çdo veprimi të planifikuar në të gjitha çështjet e ujit. Furnizimi me ujë është më shumë se vetëm ndërtimi i sistemeve të ujësjesit", është theksuar në njoftimin e Kompanisë Rajonale të Ujësjesit "Prishtina" Sh. A.

Rahoveci përkujton dëshmorët e kombit



RAHOVEC, 6 NËNTOR (ER) - Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me OVLUÇK-në dega në Rahovec, kanë organizuar të mërkurën aktivitete në nderim jetës dhe veprës së dëshmorëve të kombit Xhelal Hajda-Toni, Selajdin Mullabazi-Mici nga Rahoveci, Hamdi Hajrizi, Bektesh Haliti dhe Nezir Imeri nga Vushtrria.

Aktivitetet për shënimin e 21-vjetorit të rënies së dëshmorëve kanë filluar me nderime dhe homazhe te vendi i rënies tek udhëkryqi mbi fshatin Opterushë dhe fillimi i ndërtimit të kullës prej guri, për nder të dy heronjve Xhelal Hajda-Toni dhe Selajdin Mullabazi-Mici, për të vazhduar me homazhe te lapidari i heronjve, Xhelal Hajda-

Toni, Selajdin Mullabazi-Mici dhe shënimin i ditës së Shkollës së Mesme të Lartë "Xhelal Hajda-Toni", aktivitet ky që është mbajtur në Shtëpinë e Kulturës "Mensur Zyberaj" në Rahovec. Në aktivitetet për shënimin e 21-vjetorit të rënies së dëshmorëve Xhelal Hajda-Toni, Selajdin Mullabazi-Mici, Hamdi Hajrizi, Bektesh Haliti dhe Nezir Imeri ka

marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë, familjarë dhe bashkëluftëtarë të dëshmorëve. "Emri i tyre është kalitur në çdo mendje e në çdo zemër me një krenari të pamasë. Emrat e tyre sot gëzojnë rrugët e më e mira e kësaj gëzojnë shkollat - vatrat e kulturës e të arsimit, nga ku buron dija e bashkë me to

buron dashuria për atdheun siç edhe e kishin ata. E ardhmja ndërtohet çdo ditë dhe përkushtimi ynë duhet të bazohet mbi këto flijime të mëdha. Dëshmorët që po i kujtojmë sot na tregojnë se përjetësia u takon atyre, ndërsa neve na mbetet të punojmë pa u ankuar e pa u ligështuar, ngaqë jeta nuk ka çmim", ka thënë kryetari Latifi.

Në Prizren hiqen tabelat reklamuese

PRIZREN, 6 NËNTOR (ER) - Drejtoria e Inspektorateve në Prizren ka filluar heqjen e tabelat reklamuese, të vendosura në pjesë të ndryshme të

qytetit, pa leje të organeve kompetente komunale. Të gjitha këto tabela të vendosura në mënyrë të kundërligjshme në hapësira të

ndryshme do të largohen deri në fund të javës. Drejtoria e Inspektorateve ka apeluar te të gjithë qytetarët, të cilët janë të interesuar për shfrytëzimin

dhe vendosjen e tabelave informuese (bilbordeve), që t'i respektojnë procedurat ligjore për shfrytëzim të hapësirave publike.



IKD-ja: Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial përballen me joefikasitet

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin "Progresi dhe regresi i këshillave: Raport i monitorimit të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial (1 prill - 30 qershor 2019)". Gjetjet e IKD-së tregojnë se Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 janë përballur me mungesë efikasiteti, llogaridhënie dhe integriteti në ushtrimin e përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), me përkrahje të Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtarë dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe NED-it, ka publikuar raportin "Progresi dhe regresi i këshillave: Raport i monitorimit të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial (1 prill - 30 qershor 2019)".

Gjetjet e IKD-së tregojnë se Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 janë përballur me mungesë efikasiteti, llogaridhënie dhe integriteti në ushtrimin

e përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore.

Tremujori i dytë i vitit 2019, sikurse edhe në vitet e mëhershme, nuk ka shënuar përparim në drejtim të shtimit të efikasitetit të këtyre mekanizmave të kontrollit, veçanërisht te sistemi gjyqësor. Në anën tjetër, gjatë vitit 2019 janë shënuar shumë raste kur gjykatës, prokurorë, kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të caktuar kanë rënë në kundërshtim me parimet dhe kodin e etikës, por asnjë prej tyre nuk është shkarkuar për shkak të performancës së dobët apo për shkak të masave disiplinore.

Përjashtim bën KPK-ja, e cila gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019, përmes masës disiplinore

ka propozuar për shkarkim një prokuror si dhe ka degraduar një prokuror tjetër brenda sistemit prokurorial. Sipas legjislacionit pozitiv, këshillat obligohen që çdo tre muaj t'i ftojnë kryetarët e gjykatave, respektivisht kryeprokurorët e prokurorive, për të raportuar para anëtarëve të këshillave. Përderisa KGJK-ja këtë obligim ligjor e ka përmbushur, KPK-ja nuk është marrë fare me këtë çështje. Pavarësisht prej faktit se ka një ngritje relative të efikasitetit të dy këshillave në miratimin e legjislacionit sekondar, për shkak të akumulimit të madh të obligimeve të pazbatuara ndër vite nga të dy këshillat, ende ka rregullore të pamiratuara, obligimi për miratimin e të cilave ka qenë qysh nga ligjet e kaluara, të cilat tanimë janë shfuqizuar.

IKD-ja përgjatë monitorimit të KGJK-së ka gjetur se nuk është përmbushur obligimi ligjor për themelimin e degëve të reja të Gjykatës Themelore të Prishtinës në Komunën e Fushë-Kosovës dhe Obiliqit. Sikurse përcaktohet në ligj, themelimi i tyre do të ndikonte në shkarkimin e gjykatës më të ngarkuar me lëndë në vend, asaj në Prishtinë, si dhe do ta rriste qasjen në drejtësi për qytetarët e

këtyre komunave.

Transparenca me publikun, mediat dhe shoqërinë civile, mbetet ende sfidë për KGJK-në dhe KPK-në, të cilën sfidë asnjëri këshill nuk ka vullnet ta tejkalojë. Sa i përket KGJK-së, të gjeturat e IKD-së për transparencën e KGJK-së gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 tregojnë se nëse shikohet tremujori i dytë i këtij viti si periudhë e ndarë, KGJK-ja ka një përparim të theksuar të transparencës në disa fusha të caktuara.

Sa i përket periudhës së kaluar, përkatësisht akteve nënligjore që KGJK-ja ka nxjerrë para 1 prillit 2019, pothuajse është ruajtur status-quo, në kuptim që KGJK-ja as gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 nuk ka bërë publikimin e atyre dokumenteve.

Ndërsa sa i përket sistemit prokurorial, IKD-ja gjen se ky sistem ka një regres rapid sa i përket nivelit të transparencës, sidomos pas centralizimit të informacionit prokurorial nga Kryeprokurori i Shtetit, përmes Rregullores së KPK-së për Shërbimin e Komunikimit në Sistemin Prokurorial.

Gjatë vitit 2018 përqindja e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe informata në të cilat IKD-ja

nuk kishte marrë përgjigje kishte qenë 51.45 për qind, derisa kjo përqindje kishte rënë gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 në 19.23 për qind, i cili fakt në raportin e kaluar të IKD-së është evidentuar si përparim. Por, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019, pra pas centralizimit të informacionit nga ZKSh-ja, kjo përqindje është ngritur në 81.03 për qind. Kjo e dhënë flet për atë se sistemi prokurorial tanimë është pothuajse hermetikisht i mbyllur dhe plotësisht jotransparent, përpos rasteve përjashtuese.

IKD-ja ka gjetur se këshillat vazhdojnë qasjen e njëjtë në raport me marrjen e vendimeve si dhe miratimin e legjislacionit sekondar, duke bërë shkelje të vazhdueshme të ligjit. Këto veprime të këshillave cenojnë rëndë ligjshmërinë dhe legjitimitetin e sistemit të drejtësisë në Kosovë. Po ashtu, si në KGJK ashtu edhe në KPK mungon qasja profesionale në raport me draftimin e legjislacionit sekondar të këshillave.

Mungesa e vullnetit dhe integritetit të dy këshillave për t'i përmbushur me efikasitet, integritet dhe profesionalizëm obligimet e tyre kushtetuese dhe ligjore është mesazhi më i keq që këta dy këshilla mund të përçojnë te gjykatësit dhe prokurorët, si dhe te publiku i gjerë. Kjo qasje e shndërron në parim të punës joefikasitetin, mungesën e llogaridhënies dhe pandëshkueshmërinë.

Në pjesën e gjetjeve të veçanta të monitorimit të IKD-së për sistemin gjyqësor dhe prokurorial, raporti trajton temën e procesit të rekrutimit të gjyqtarëve të departamenteve speciale, "kërcënimin" e Sindikatës së Judikaturës për futje në grevë, kërcënimin me bombë në KGJK, ndërprerjen e procesit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të PSRK-së, dështimin në praktikë të Rregullores së KPK-së për Shërbimin e Komunikimit, "luftën e ftohtë" të KPK-së me koordinatoren Shqipdon Fazliu si dhe shpërblimin që KPK ia ka bërë në mënyrë të kundërligjshme Kujtim Munishit për ta emëruar si ushtrues detyre të kryeprokurorit të Prishtinës. Në fund raporti ofron rekomandimet konkrete se si të rrite transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien në sistemin prokurorial dhe gjyqësor.



UPZ-ja arrin marrëveshje me Zyrën Austriake për Shkëmbime Akademike

PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER) - Prof. asoc. dr. Ismet Temaj, rektor i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", së bashku me prorektorët prof. ass. dr. Shemi Morina dhe prof. ass. dr. Soner Yildirim, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën

Austriake për Shkëmbime Akademike (OeAD) me qëllim të zhvillimit dhe përparimit të mësimdhënies e mësimnxënies në Fakultetin e Filologjisë, respektivisht në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane. Kjo marrëveshje thellon

bashkëpunimin në mes të këtyre dy institucioneve dhe kontribuon për institucionalizimin e mëtejshëm të zyrës së programit të rektoratit austriak për pesë vjet akademikë në kuadër të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren.



Kërkohet që OShP-ja ta rrisë konsistencën në vendimmarrje

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Demokraci Plus (D+) ka mbajtur një tryezë diskutimi në të cilën ka publikuar raportin "Roli i Organit Shqyrtues të Prokurimit në mosefikasitet në prokurim publik". D+ka analizuar të gjitha vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për periudhën qershor 2018 - maj 2019.

Disa prej të gjeturave kryesore janë: mungesa e konsistencës në vendimmarrje, e cila zvogëlon besimin në vendimet e OSHP-së. E gjetur tjetër është se OSHP-ja

në përgjithësi injoron ligjet e tjera të aplikueshme, siç është Ligji i Punës dhe kjo krijon probleme për tenderët për sigurim fizik dhe pastrim të objekteve ku punëtorët janë të nënpaguar dhe punojnë me orar të tejzgatur. Christine Danton nga USAID-i ka theksuar nevojën që të rritet besimi në institucionet e Kosovës dhe që OSHP-ja ta rrisë konsistencën në vendimmarrje. Ajo ka thënë, gjithashtu, se shpreson që qeveria e re do t'i zgjedhë dy anëtarët e tjerë të OSHP-së.

Kryetari i Bordit të OSHP-së, Blerim Dina, ka pranuar që ka

jokonsistencë në vendimmarrje dhe ka treguar hapat që do t'i marrë OSHP-ja për ta përmirësuar këtë. Ai ka thënë se tani të gjithë ekspertët që bëjnë ekspertizat e tyre kanë format e caktuara të cilat duhet t'i plotësojnë. Dina ka shtuar se janë duke marrë hapa për ta përmirësuar konsistencën pasi kjo po shihet si vrimë e zezë për OSHP-në.

Paneli shqyrtues i OSHP-së përballat me shumë rekomandime të gabuara nga ekspertët shqyrtues, të cilët bëjnë gabime duke filluar nga llogaritje të thjeshta matematikore e deri te gabimet ku deklarojnë se disa

dokumente nuk janë kërkuar në dosje të tenderit.

Demokraci Plus ka theksuar se ky është një problem i madh për OSHP-në dhe duhet të merren masa që të rishikohen të gjitha rekomandimet e ekspertëve shqyrtues. Gjatë diskutimit, një tjetër problem u prezantua në lidhje me listën e zezë joefektive për kompanitë që shkelin ligjin. Demokraci Plus ka gjetur se kompanitë e vendosura në listë të zezë po janë të lira që të ofertojnë në tenderë të tjerë, ndërsa ligji thotë që kompanitë në listë të zezë nuk kanë të drejtë të ofertojnë gjatë kohës që janë në këtë

listë. Në fund, Demokraci Plus i ka rekomanduar OSHP-së që të marrë masa për t'i përmirësuar vendimet e OSHP-së.

Gjithashtu, Demokraci Plus i ka rekomanduar OSHP-së që t'i auditojë të gjitha rekomandimet e ekspertëve, të krijojë një databazë të vendimeve të mëhershme dhe ta përdorë databazën nga D+ në mënyrë që ta përmirësojë situatën në lidhje me vendimet jokonsistente. Një rekomandim tjetër ishte që OSHP-ja t'i publikojë të gjitha ankesat, rekomandimet e ekspertëve dhe dokumentet e tjera në uebfaqen e OSHP-së.



Inspektorët largojnë mallrat e ekspozuara në trotuaret e qytetit të Mitrovicës

MITROVICË, 6 NËNTOR (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Komunën e Mitrovicës, nën asistimin e Policisë së Kosovës, të mërkurën ka ndërmarrë aksion, duke mos lejuar shitësit e ndryshëm, që produktet e tyre t'i ekspozojnë në trotuare dhe hapësira të tjera publike, të parapara për shfrytëzim nga ana e qytetarëve.

Inspektorët komunalë kanë bërë me dije se shitësit i kanë respektuar urdhëresat e inspektorëve dhe nuk ka pasur nevojë për intervenim të Policisë apo

shqiptim të ndëshkimeve mandatore. Kjo gjë, sipas tyre, flet për faktin se shitësit po e kuptojnë seriozitetin e angazhimit të inspektorëve komunalë dhe rëndësinë e lirim-it të hapësirave publike për lëvizje të lirë e pa pengesa të qytetarëve.

Drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka theksuar se aksione të ngjashme do të ketë në vazhdimësi derisa të mos ketë ekspozim të mallrave nëpër trotuare dhe të mos ketë pengesa në lëvizjen e qytetarëve.



Taksa e lë pa para Fondin për zhvillimin e veriut

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Taksa e vendosur ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina ka varfëruar Fondin e Mirëbesimit, i cili është krijuar për zhvillimin e komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës, thonë përfaqësues të shoqërisë civile në pjesën veriore të Kosovës. Fondi i Mirëbesimit është themeluar mbi bazën e Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2013 për doganat, ku Prishtina dhe Beogradi, me lehtësimin e Bashkimit Evropian, ishin marrë vesh për themelimin e tij në funksion të zhvillimit të komunave në veri të Kosovës, të banuara me shumicë serbe. Sipas kësaj marrëveshjeje, paratë e mbledhura përmes mallrave që importohen në pikat kufitare në veri, përkatësisht në Jarinë dhe Bërnjak, të destinohen në fondin për zhvillimin e katër komunave veriore: Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit.

Deri në fund të vitit 2018 vlera e këtij fondi ka arritur mbi 15.5 milionë euro, kurse 11 milionë euro janë shpenzuar në 30 pro-

jekte të ndryshme, disa nga të cilat janë në fazën e zbatimit, thuhet në faqen zyrtare të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Fondi, sipas BE-së, favorizon investimet në projektet publike, të cilat mund të kenë ndikim në zhvillimet socio-ekonomike në komunat në veri. Veçanërisht, projektet që propozohen duhet të kenë për qëllim përmirësimin e jetës së banorëve lokalë. Këto projekte duhet të jenë financiarisht të zbatueshme, me kosto efektive, substanciale dhe të jenë në mbrojtje të mjedisit.

Destinimi i fondit ndërlidhet me projektet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike, përfshirë rrugët, spitale, furnizimin me ujë, trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave. Po ashtu, fondi mbështet edhe projektet për bizneset, gratë, shoqërinë civile, promovimin e të drejtave të njeriut, arsimin, qasje në kujdesin shëndetësor dhe transportin. Por, që nga nëntori i vitit 2018, kur Qeveria e Kosovës vendosi taksën doganore 100 për qind ndaj të

gjitha importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, importet nga Serbia kanë rënë në minimum.

Përfaqësues të shoqërisë civile në pjesën veriore të Kosovës thonë se që nga vendosja e taksës sasia e importit është zvogëluar dukshëm dhe rrjedhimisht edhe të hyrat për këtë Fond.

Dragisha Mijaçiq, nga Instituti për Zhvillim Ekonomik Territorial (INTER), në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" tha se që nga vendosja e taksës nuk ka më mjete që grumbullohen në këtë fond dhe rrjedhimisht nuk ka as financim të projekteve të reja. "Në vitin e fundit mendoj se ka pasur krejtësisht pak mjete që janë derdhur në atë fond dhe natyrisht se ky është një nga efektet më negative që ka ndodhur me futjen e taksës për mallrat që vijnë nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Pikërisht për këtë shkak, fondi për zhvillimin e katër komunave të veriut të Kosovës, e ka humbur çdo kuptim", tha Mijaçiq.

Funksionimi i fondit vendoset nga bordi menaxhues. Ky bord

përbëhet nga tre anëtar: I dërguari i posaçëm i BE-së në Kosovë ka postin e kryetarit, ministri i Financave të Kosovës merr pjesë në emër të autoriteteve të Kosovës dhe një përfaqësues i komunitetit serb që vjen nga katër komunat veriore.

Në faqen zyrtare të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë thuhet se të ardhurat nga të dyja pikat e kalimit transferohen në një llogari në një bankë tregtare në Prishtinë të përcaktuar nga BE-ja.

Edhe Lulzim Rafuna, këshilltar i ministrit në largim të Financave, Bedri Hamza, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", thotë se deri më tani janë shpenzuar më shumë se 11 milionë euro apo 78 për qind e fondit për projekte të ndryshme. "Projektet kapitale kanë të bëjnë me projekte të ujit, me çështjen e ndërtimit të rrugëve, ndërtimin ose rindërtimin e shkollave, në qendrat sportive që ndihmojnë në socializimin e të rinjve, e tjera", tha Rafuna.

Ndërkaq Dragisha Mijaçiq thotë se mjetet nga ky fond janë

shfrytëzuar për ndërtimin e rrugëve, blerjen e pajisjeve, ndërtimin e objekteve të ndryshme publike. Rrallëherë, thotë ai, projektet kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik, duke dyshuar se kohët e fundit ka mungesë edhe të transparencës për projektet e fituara. "Mjetet më shumë janë shpenzuar për zhvillimin e infrastrukturës komunale, infrastrukturës sportive ose në objektet që kanë rëndësi kulturore, në arsimim dhe të tjera. Karakteristikë për Fondin Zhvillimor është që kohët e fundit është zvogëluar transparenca, madje edhe rreth raportimeve për atë se cilat projekte kanë fituar të drejtën për financim dhe cilat jo", tha Mijaçiq.

Bazuar në një raport të publikuar në faqen zyrtare të BE-së, edhe pse të dhënat nuk janë të fundit, Komuna e Mitrovicës së Veriut ka shpenzuar më shumë se 3.4 milionë euro nga ky fond, pasuar nga Komuna e Zveçanit me 3 milionë euro, Komuna e Zubin Potokut me mbi 2.5 milionë euro dhe Komuna e Leposaviqit me mbi 2 milionë euro.



Sezoni dimëror, Ministria e Infrastrukturës gati për mirëmbajtje të rrugëve

Prishtinë, 6 nëntor (ER) - "Sezoni dimëror po afron dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit është gati për mirëmbajtje të rrugëve", kësh-

tu ka thënë ministri në detyrë i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj. Ai ka shtuar se për punë të suksesshme edhe këtë vit janë

koordinuar menaxherët dhe të gjitha departamentet relevante në MIT, prej të cilëve është informuar edhe për përgatitjet e fundit. "Nga ata

kërkova angazhim maksimal për rrugë të kalueshme gjatë gjithë dimrit", ka shkruar Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook".



FALSIFIKIMI I RAPORTIT TË EKSPERTIZËS ZVICERANE PËR RASTIN 'ASTRIT DEHARI' NË FUNKSION TË FSHEHJES SË KRIMIT



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

Pasi kanë analizuar videoincizimet dhe fotografitë e autopsisë, të bëra nga mjekët-ligjorë të Republikës së Kosovës gjatë autopsisë së trupit të Astrit Deharit, ekspertët e Njësisë Romande të Mjekësisë Forenzike të Qendrës Universitare Ramande të mjekësisë ligjore në Lozanë të Zvicrës kërkojnë ndryshimin dhe plotësimin e pikave të caktuara të ekspertizës së kryer në Kosovë.

Sa iu përket lëndimeve që shihen nga ekzaminimi i jashtëm i trupit të të riut, ekspertët zviceranë kërkojnë ndryshimin dhe plotësimin e 15 diagnozave, që numërohen në 15 pika, të paraqitura në faqet 24-25 të raportit të datës 14 qershor 2019.

Çështja e parë që ekspertët zviceranë shtrojnë për rishikim ka të bëjë me diagnozën e shenjave që shihen në pjesën e sipërme, të mesme dhe paramediane, në anën e djathtë të ballit, në pjesën e mbuluar me flokë, rreth 4,5 cm mbi vetullën e djathtë, të shtrira mbi një sipërfaqe rreth 4 cm.

Në raportin e autopsisë të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës këtyre shenjave u jepet diagnoza "lëkurë e dëmtuar" (tekstualisht "lëkurë e dremishur"). Kjo diagnozë hidhet poshtë nga ekspertiza zvicerane sepse "katër pllakat e kuqërremta që shihen në pjesën e sipërme, të mesme dhe paramediane në anën e djathtë të ballit, në pjesën e mbuluar me flokë tek Astrit Dehari janë pllaka pergamene".

Për ta bërë më të qartë dallimin thelbësor në interpretimin e këtyre pllakave në ballin e të ndjerit Astrit

Dehari, ekspertët zviceranë i kush-tojnë një rëndësi të veçantë shpjegimit të nocioneve që përdorin. Për dallim nga eritema (skuqe), që është një lëndim sipërfaqësor i lëkurës dhe që është e dukshme për një kohë të shkurtër, "ekimozat (mavijosjet) janë pasoja të veprimeve të dhunshme, që shkaktohen nga goditje me sende të forta (përplasje e trupit me një apo shumë sende të forta, goditje të marra nga një ose më shumë sende të forta, ndrydhje të forta lokale". (Shkrimi me shkronja kapitale është bërë për ta tërhequr vëmendjen).

Në përkthimin shqip të ekspertizës ky përkufizim është përkthyer në këtë mënyrë: "Ecchymosis janë pasoja të traumave të hapura (përplasje e trupit kundër një apo shumë objekteve shtypëse, presione lokale të forta".

Nuk do të flasim këtu për nivelin e përkthimit të këtij përkufizimi. Ajo që duhet të theksohet në këtë kontekst ka të bëjë me faktin se në përkthim është hequr fjalia që saktëson se këto lëndime mund të shkaktohen edhe nga "goditjet e

marra nga një ose më shumë sende të forta".

Arsyet e heqjes së kësaj fjalie janë të qarta: të shmanget çdo fjali që mund të lërë të nënkuptohet se lëndimet që ka pasur Astrit Dehari mund të jenë pasojë e goditjeve me sende të forta.

Kush e hoqi këtë fjali nga ekspertiza mjeko-ligjore zvicerane? Nëse e ka bërë përkthyesi dhe pretendon të mos e ketë ditur që në gjuhën frënge shprehja "traumatisme contandant" nënkupton tërësinë e veprimeve të dhunshme që shkaktojnë lëndime pa çarje dhe prerje të lëkurës, lëndime që shkaktohen nga goditje me sende të forta dhe jo të mpërhta, as ai dhe askush tjetër që ka përfunduar studimet në gjuhën frënge nuk mund të thotë se nuk e di që në gjuhën frënge "coups reçus par un/des objets..." do të thotë "goditje që ka marrë nga një ose më shumë sende...". Sidomos këtë çështje e di fare mirë Ismail Ismaili, përkthyesi i këtij dokumenti, që deklaroi: "Raporti shkencor duhet të përkthehet pothuajse fjalë për fjalë. Nuk kam guxuar t'i interpretoj thëniet e

ekspertëve mjeko-ligjorë". Në rastin konkret është prerë si me gërshërë "fjalë pas fjale" fjalia që lë të nënkuptohet se Astrit Dehari është goditur.

Manipulimi me përkufizimin e lartpërmendur është vetëm një nga goditjet që ka marrë raporti i ekspertizës zvicerane nëpërmjet përkthimit. Do t'i kthehem kësaj çështjeje edhe një herë, kur ta trajtojmë kontekstin e plotë të kësaj fjalie në ekspertizën që bëjnë zviceranët. Atëherë do të shihet edhe më qartë qëllimi i vërtetë pse janë hequr disa fjali.

Çështja e dytë që sqarojnë ekspertët mjeko-ligjorë zviceranë është termi "pllaka pergamene". Pllakat pergamene përkufizohen si "pllaka që formohen si pasojë e tharjes së lëkurës që ndodh pas vdekjes, në zonat e dëmtuara të epidermës nga veprime të dhunshme, që shkaktohen nga goditje me sende të forta (përplasje e trupit me një apo shumë sende të forta, goditje të marra nga një ose më shumë sende të forta, ndrydhje të forta lokale, me një forcë që ushtron shtypje të shoqëruar me

një lëvizje fërkuese".

Në përkthimin shqip të ekspertizës ky përkufizim është përkthyer në këtë mënyrë: "Pllakat pergamene janë pasojë e tharjes past-mortum të lëkurës, në shikim të zonave të pastrimit të epidermës pas traumave të hapura (përplasje e trupit kundër një apo shumë objekteve shtypëse, presione lokale të forta) me një përbërës tangjencial".

Përsëri nuk do ta trajtoj "nivelin shkencor të përkthimit fjalë për fjalë". Edhe në këtë kontekst kemi të bëjmë me faktin se në përkthim është hequr fjalia që saktëson se këto lëndime mund të shkaktohen edhe nga "goditjet e marra nga një ose më shumë sende të forta".

Ai që ka hequr këtë fjali nga përkthimi mund të mos e ketë ditur se në gjuhën frënge shprehja "une composante tangentielle" do të thotë "një forcë që ushtron shtypje shoqëruar me një lëvizje fërkuese", mirëpo një gjë duhet të dihet: sado që të mundohen ta "fërkojnë fjalinë", "goditjet e marra nga një ose më shumë sende të forta" në rastin "Astrit Dehari" nuk hiqen vetvetiu. Ato janë hequr qëllimisht

ÇELËSI I KRAHUT
Frëngjisht: CLÉ DE BRAS
Anglisht: ARMLOCK

EKSPERTIZA ZVICERANE: Lëndimet në qafën e Astrit Deharit nuk janë lëndime sipërfaqësore, siç i kanë cilësuar ekspertët mjeko-ligjorë të Kosovës, por lëndime të thella, që vërehen në vendet karakteristike për lëndimet që janë shkaktuar gjatë kapjeve në qafë, të llojit 'çelësi i krahut', ose formave të tjera të dhunës në qafë.



Përfundon studimi i fizibilitetit për ngrohjen qendrore solare në kryeqytet

PRISHTINË, 6 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se ka përfunduar studimi i fizibilitetit për ngrohjen qendrore solare në këtë komunë. Ai në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ky projekt do t'i shtojë kapacitetet

e Termokosit për ngrohje në disa lagje të kryeqytetit. "Në bashkëpunim me KfW-në dhe BERZh-in kemi përfunduar studimin e fizibilitetit për ngrohjen qendrore solare në komunën tonë. Ky projekt do t'i shtojë kapacitetet e Termokosit për ta zgjeruar rrethinë në lagjet

me banim individual si Tophane, Arbëri e Medrese. Por, me më rëndësi, do ta zëvendësojë qymyrin me energji të ripërtërishtme diellore. Ky projekt synon që brenda 3-5 vjetëve të ardhshëm ta zgjerojë rrethinë përtej projektit të kogenerimit e që po bëhet edhe në Kalabri,

Mat e qendër", ka thënë ai. Ahmeti ka theksuar se projekti do të financohet potencialisht nga KfW-ja, BERZh-i, grante të donatorëve e financim të komunës. "Përndryshe, ky do të jetë ndër tri projektet më të mëdha të këtij lloji në Evropë", ka deklaruar Ahmeti.



nga teksti i ekspertizës zvicerane. Diagnoza e lëndimeve të konstatuara në pjesën e sipërme, të mesme dhe paramediane në anën e djathtë të ballit, në pjesën e mbuluar me flokë tek Astrit Dehari si "pllaka pergamene" është tepër domethënëse. Pllakat pergamene nuk janë shenja lëndimesh sipërfaqësore të lëkurës, por pamja që merr lëkura disa orë pas vdekjes në vendet ku janë shkaktuar lëndime të brendshme të indeve ose të organeve nga goditja me sende të forta. Prandaj, gjatë autopsisë duhet të bëhen prerje të thella në muskuj, për t'i nxjerrë në pah ekimozat ndërlekurore apo ndërmuskulore të cilat mund të mos shfaqen në kohën kur bëhet ekzaminimi.

Përveç lëndimeve në ballë të Astrit Deharit, në raportin e autopsisë të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës, edhe lëndimeve që shihen në pjesën anësore të qafës, në anën e djathtë dhe ato të pjesës së poshtme nga ana e brendshme e parakrahut të majtë u jepet diagnoza "lëkurë e dëmtuar". Ekspertiza mjeko-ligjore zvicerane hedh poshtë diagnozat e ekipit mjeko-ligjor të Kosovës, sepse lëndimet, në qafë dhe parakrah të Astrit Deharit, nuk janë lëndime sipërfaqësore, por pllaka pergamene, që shprehin lëndime të brendshme të indeve ose të organeve nga goditja me sende të forta.

Ekspertët mjeko-ligjorë zviceranë përmendin mendimin e mjekëve ligjorë të Kosovës, sipas të cilëve, "lëndimet që gjenden në anën e djathtë të pjesës anësore të qafës (latero-cervical), në pjesën e sipërme ballore (frontalo-superiore) dhe në anën e brendshme të parakrahut të majtë, mund të jenë shkaktuar gjatë bartjes së trupit, gjatë ecurisë mjekësore për ta kthyer në jetë ose nga 'tkurrja e menjëhershme muskulore' që e shoqërojnë në pengimin e rrugëve të frymëmarrjes gjatë kontaktit me një objekt të 'skenës së krimi'".

Ekspertët zviceranë nuk pajtohen me këtë interpretim. Sipas vëzhgimeve të tyre, "numri i madh i pllakave pergamene në pjesën e djathtë anësore të qafës (lateralocervikal), globalisht mund të ndahen në dy gupe. Grupi i parë përbëhet nga pllakat pergamene lineare, të pjerrëta nga lart-poshtë dhe përpara trupit, kryesisht paralele ndërmjet tyre, të vendosura në të njëjtin aks me plagët sipërfaqësore në të njëjtin vend. Megjithatë, ato janë shkaktuar nga veprime të dhunshme me mjete të forta dhe jo të mprehta. Grupi i dytë përbëhet nga pllakat pergamene me madhësi dhe forma të ndryshme; disa në formë harku dhe, në

përgjithësi, formojnë një hark rrethor të rumbullakët në pjesë e përparme. Sipas mendimit tonë, nuk ka mekanizëm bindës që do të shpjegonte se si është e mundur që këto pllaka pergamene të jenë shfaqur gjatë bartjes së trupit, gjatë përpjekjeve për ta kthyer në jetë ose gjatë tkurrjes muskulore të menjëhershme. Në fakt, nuk kemi të bëjmë me zona ku bëhen kapjet gjatë bartjes (në rastin e transportit); nuk kemi të bëjmë me zona ku bëhen ndërhyrjet mjekësore në rastet urgjente (në rastin e përpjekjeve për ta kthyer në jetë) dhe as zona të skajshme të trupit, si: hunda, veshi, molla e Adamit, bërryli, të cilat do të ishin përplasur me pengesa në rastin e bartjes ose shtangimit muskolor... edhe pse teorikisht ato mund të shkaktoheshin nga bartja e trupit, nga veprimet për ta kthyer në jetë ose nga tkurrja muskulore, as pamjet e lëndimeve, as vendi ku gjenden këto lëndime nuk pasqyrojnë, në radhë të parë, lëndime të shkaktuar nga njëri prej këtyre tre mekanizmave.

Tri ekimozat (mavijosjet) që ndodhen në anën e brendshme të parakrahut të djathtë, për nga vendi dhe forma e tyre mund të paraqesin lëndime të shkaktuara nga një kapje me dorë. Ato mund të kenë qenë të shkaktuara gjatë transportit të trupit ose përpjekjeve mjekësore për ta kthyer në jetë, ashtu siç janë të paraqitura nga mjekët ligjorë. Megjithatë, një kapje me dorë e llojit kur dikush mbahet me zor nuk mund të përjashtohet dhe duhet të përmendet".

Në vazhdim të vënies në pah të pasaktësive që përmban autopsia që ka bërë ekipi mjeko-ligjor i Kosovës lidhur me lëndimet që shihen në ekzaminimin e jashtëm, ekspertët zviceranë përmendin lëndimin në këndin e nofullës së poshtme, në pjesën e përparme të anës së djathtë të saj. Ky lëndim nuk përmendet fare në autopsinë e ekipit mjeko-ligjor të Kosovës.

Kur bëhet fjalë për lëndimet në nofullën e poshtme, ekipi mjeko-ligjor i Kosovës, në pikën 4 të raportit të autopsisë të datës 7 nëntor 2016, kufizohet vetëm në lëndimin që shihet "në këndin e nofullës së poshtme, në anën e djathtë të saj, rreth 4 cm nga cepi i poshtëm i laprës së veshit" dhe i jep diagnozën "skuqje (eritemë) në formë vezake, me ngjyrë rozë, me përmasa rreth 10 x 9 mm. Skuqje të ngjashme ndodhen edhe në faqen e jashtme të poshtme të parakrahut të dorës së djathtë (3 në numër) pranë njëra-tjetrës, me përmasa nga 5 x 5 mm deri 12 x 8 mm, si dhe në faqen e jashtme të shuplakës së dorës së

djathtë, në nivel të rrënjës së gishtit të tretë, me përmasa rreth 12 x 10 mm".

Sipas ekspertëve zviceranë, këtu nuk kemi të bëjmë me "skuqje (eritemë)", por me mavijosje (ekimozë). "Ekimozat (mavijosjet) që ndodhen në këndin e nofullës së poshtë në anën e djathtë dhe në pjesën e përparme të nofullës së poshtme në anën e djathtë, mund të jenë shkaktuar edhe gjatë veprimeve për ta kthyer në jetë (të llojit "headtilt/chin lift" ose "jawthrust), por nuk janë karakteristike e lëndimeve që lidhen me bartjen apo transportin e trupit. Nga ana tjetër, këto ekimozat (mavijosje) vërehen në vendet karakteristike për lëndimet që janë shkaktuar gjatë kapjeve në qafë, të llojit 'çelësi i krahut' ("clé de bras" në gjuhën frënge), ose formave të tjera të dhunës në qafë. Për shkak të këtij fakti, një mekanizëm i tillë i lëndimit nuk mund të përjashtohet dhe duhet të përmendet".

Vetëm në këtë kontekst mund të kuptohen arsyet e vërteta pse u falsifikua përkufizimi i ekspertëve mjeko-ligjorë të Zvicrës për "ekimozën, si pasojë e veprimeve të dhunshme, që shkaktohen nga goditje me sende të forta (përplasje e trupit me një apo shumë sende të forta, goditje të marra nga një ose më shumë sende të forta, ndrydhje të forta lokale".

E njëjta mënyrë e heqjes së fjalive u përdor edhe në disa pjesë të tekstit të raportit të ekspertizës zvicerane. Kështu, në pjesën ku flitet për lëndime, që shihen edhe nga ekzaminimi i jashtëm, ekspertiza zvicerane numëron katër lëndime të cilat nuk janë të përshkruara në raportin e autopsisë të bërë në Kosovë.

Si lëndim të parë që nuk është përshkruar në raportin e autopsisë të bërë në Kosovë, ekspertët zviceranë përmendin "një ekimozë me ngjyrë të kuqe në kafe, në formë vezake, në skajin e pjesës së përparme (antero-inferiore) të nofullës së poshtme".

Fjalja është fshirë e gjitha! Nga pretendimi i përkthyesit, se ka bërë përkthim "shkencor fjalë për fjalë" të raportit zviceran, dikush ka përdorur metodën "shkencore të prerjes fjalë pas fjale" të fjalisë në tërësi, me qëllim që të hiqet edhe nga raporti i ekspertizës zvicerane ajo që nuk ekziston në raportin e autopsisë së Kosovës. Ky falsifikim është bërë me të vetmin qëllim, që të fshihet diagnoza se kemi të bëjmë edhe me një ekimozë shtesë, "që shkaktohet nga goditje me sende të forta (përplasje e trupit me një apo shumë sende të forta, goditje të marra nga një ose më shumë sende të forta, ndrydhje të forta lokale".

Policët e Malishevës dhurojnë gjak

MALISHEVË, 6 NËNTOR (ER) - Pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të Stacionit në Malishevës, po e vazhdojnë traditën e dhënies vullnetare të gjakut për nevojat e spitaleve në vendin tonë. Edhe sot, zyrtarët policorë, por edhe qytetarë të tjerë, i janë përgjigjur aksionit për dhënien vullnetare të gjakut, aksion i cili është duke u mbajtur në ambientet e stacionit policor, nga ana e Entit të Transfuzionit të Gjakut. Në fillimin e këtij aksioni ishte i pranishëm edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili i ka përgëzuar profesionistët shëndetësorë të Entit të Transfuzionit të Gjakut, por edhe zyrtarët policorë në



Malishevë për gatishmërinë e tyre dhe gjestin human që po e bëjnë, pasi një dozë e gjakut, mund të shpëtojë një jetë njeriu. I pari që e filloi aksionin e dhënies vullnetare të gjakut ishte komandanti i Stacionit Policor në Malishevë, kapiteni Azem Krasniqi, e më pas edhe zyrtarët e tjerë policorë dhe qytetarë të cilët ishin të njoftuar për aksionin.

Policia bëhet me zyrë në Stacionin e Autobusëve në Pejë

PEJË, 6 NËNTOR (ER) - Policia e Kosovës në Pejë ka hapur zyrën në Stacionin e Autobusëve në këtë komunë. Një gjë e tillë është bërë e mundur në kuadër të implementimit të strategjisë "Policimi në bashkësi". Në këtë zyrë do të qëndrojnë zyrtarët policorë sipas orarit fleksibil, për t'i parandaluar incidentet dhe për një bashkëpunim më të mirë



me qytetarët, ka njoftuar policia. Hapësirat e Stacionit të Autobusëve në Pejë janë shumë të frekuentuara. Në të kaluarën ka pasur edhe incidente në mes të rinjve.

Fillon asfaltimi i segmenteve të rrugëve në fshatin Pemishtë të Skenderajt

SKENDERAJ, 6 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i shoqëruar nga drejtoresha e Urbanizmit, Sanie Ahmeti, inxhinierë dhe profesionistë, kanë parë nga afër fillimin e asfaltimit të segmenteve të rrugëve në fshatin Pemishtë. Kryetari Jashari ka theksuar se asfaltimi i rrugës në fshatin Pemishtë po vazhdon sipas planit. "Së bashku me bashkëpunëtorë pamë nga afër finalizimin e rrugës. Aty bashkëbiseduam me



banorë të kësaj pjese të cilët i uruam për rregullimin e infrastrukturës rrugore. Skenderaj çdo ditë e më shumë po bëhet me infrastrukturë moderne", ka thënë Jashari.

Fillon hapja e rrugës Ngucat - Javor

MALISHEVË, 6 NËNTOR (ER) - Komuna e Malishevës ka njoftuar se ka filluar hapja e rrugës që lidh fshatin Ngucat të kësaj komune me fshatin Javor të Komunës së Suharekës. Rruga është e gjatë 1 mijë e 680 metra. Nga afër punimet në këtë rrugë i

ka përcjellë nënkryetari i Malishevës, Hajdin Berisha, dhe shefi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Fadil Shala. Berisha ka thënë se rregullimi i kësaj rruge ka qenë kërkesë e kamotshme e banorëve të Ngucatit dhe Javorit. "Kjo rrugë ka qenë

kërkesë e vazhdueshme e banorëve të dy fshatrave, sepse ka rëndësi të madhe për ta dhe, falë bashkëpunimit të mirë në mes të dy komunave dhe Ministrisë së Infrastrukturës, është mundësuar hapja dhe rregullimi i tërësishëm i kësaj rruge

që, përveç lidhjes në mes të dy fshatrave, krijohet edhe një lidhje e re rrugore në mes të dy komunave, në pjesën e fshatrave që shtrihen në vargmalet e Berishës", ka thënë Berisha. Ky projekt është mundësuar nga Ministria e Infrastrukturës.



Demokratët shpallin fitoren në Kentaki dhe Virxhinia

WASHINGTON, 7 NËNTOR - Demokratët në Shtetet e Bashkuara kanë korrur sukses në zgjedhjet e nivelit shtetëror. Demokrati Andy Beshear pretendoi fitoren në zgjedhjet për guvernator të Kentakit, pas një gare të ngushtë, në shtetin me prijje kryesisht konservatore. Ndërkohë, demokratët morën kontrollin e plotë të organit legjislativ në Virxhinia, për herë të parë në mbi 20 vjet. Rezultatet janë duke u parë

si një matës i gjendjes politike, përpara zgjedhjeve presidenciale të vitit të ardhshëm. Sidoqoftë, republikanët mbajtën pushtetin në votimin për guvernatorin e Misisipit, pas një gare të ngushtë me demokratët.

Në Kentaki, Beshear pretendoi fitoren ndaj guvernatorit aktual, republikanin Matt Bevin, pasi rezultatet përfundimtare i dhanë një epërsi prej 0.4%. Bevin, 52 vjeç, ka thënë se nuk do ta

pranojë rezultatin, duke përmendur disa parregullsi të papërcaktuara. Sidoqoftë, demokrati Beshear, një avokat 41-vjeçar, babai i të cilit ishte ish-guvernator i shtetit, tha: "Ne do të jemi gati për ditën e parë në detyrë, dhe unë mezi po e pres atë". Në një fjalim para mijëra mbështetësve, presidenti amerikan, Donald Trump, tha se Beshear ishte "shumë ekstrem dhe shumë i rrezikshëm" për ta qeverisur shtetin e Kentakit.



Ambasadori amerikan korigjon dëshminë para hetuesve të Dhomes së Përfaqësuesve

Ambasadori amerikan në BE, Gordon Sondland, tani ka pranuar se kishte njohuri se administrata e presidentit Trump ka pezulluar një ndihmë ushtarake për Ukrainën derisa i bënte presion Kievit për t'i hetuar rivalët e presidentit amerikan Donald Trump

WASHINGTON, 7 NËNTOR - Ambasadori amerikan në Bashkimin Evropian, Gordon Sondland, ka korigjuar dëshminë e tij të mëparshme para hetuesve të Kongresit. Tani ai ka pranuar se kishte njohuri se administrata e presidentit Trump pezulloi një ndihmë ushtarake për Ukrainën derisa i bënte presion Kievit për t'i hetuar rivalët e presidentit amerikan, Donald Trump. Deklaratat e bëra publike më 5 nëntor ishin pjesë e transkripteve që u botuan këtë javë nga komitetet e udhëhequra nga demokratët, të cilët udhëheqin hetimet në kuadër të procesit të nisur për shkarkimin e presidentit amerikan Donald Trump, ka njoftuar rfe. Pas dëshmisë së Sondlandit muajin e kaluar, avokatët e ambasadorit u dhanë hetuesve të Dhomes së Përfaqësuesve një deklaratë të re të betimit, në të cilën ai përditësoi deklaratën e mëparshme, të cilat ishin bërë nën betim.

Në deklaratë, Sondland pretendon se kujtesa e tij u rifreskua pasi ai lexoi deklaratat e dy dëshmitarëve të tjerë kryesorë që dëshmuuan në hetim. Sondland tha se ai tani e mban në mend një bisedë në Varshavë, me një ndihmës të lartë të presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy. Në këtë bisedë, Sondland tha se ndihma ushtarake për Ukrainën me gjasë nuk do të procedohej derisa Kievit ta bënte të qartë se do të hetonte rivalin demokrat të Trumpit, Joe Biden dhe lidhjet e djalit të tij, Hunter Biden, me kompaninë Burisma të Ukrainës. Sondland i tha zyrtarit ukrainas, Andriy Yermak, "se procedimi i ndihmës amerikane nuk do të ndodhë gjersa Ukraina ta sigurojë deklaratën antikorrupsion, e cila po diskutohej për javë të tëra". Sondland tha se deklaratat ishin kulmi i presionit disamujor, i vendosur mbi Kievin, kryesisht përmes avokatit personal të Trumpit, Rudy Giuliani, për të



hapur hetime "anti-korrupsion" ndaj Joe dhe Hunter Biden dhe në besimin e pabazuar të Trumpit se Ukraina ndihmoi demokratët në zgjedhjet e vitit 2016. Sondland u tha hetuesve se ai e kuptoi që ky relacion ishte "i papërshtatshëm". I pyetur gjatë dëshmisë së tij nëse kjo marrëdhënie ishte e paligjshme, Sondland u përgjigj: "Unë nuk jam avokat, por kësh-tu supozoj". Ambasadori fillimisht mohoi se kishte njohuri për çdo lidhje midis ndihmës ushtarake dhe kërkesës së Trumpit që Ukraina të hetojë Joe dhe Hunter Biden.

Demokratët kanë akuzuar Trumpin për abuzim me detyrën e tij, duke bërë presion ndaj një qeverie të huaj, për të hetuar një rival politik përmes kërcënimit se do ta ndalojë ndihmën ushtarake e cila ishte e miratuar. Trumpi ka mohuar se ai ka bërë ndonjë gjë të gabuar dhe e ka quajtur procesin e fajësimit "një turp". Ndërkohë, hetuesit më 5 nëntor i kërkuan ushtruesit të detyrës së shefit të stafit të Trumpit që të paraqitej para hetuesve. Disa zyrtarë të lartë të administratës deri më tani kanë refuzuar të dëshmojnë para hetuesve të

Dhomes së Përfaqësuesve. Dhoma, e udhëhequr aktualisht nga demokratët, ka autoritetin e vetëm për ta kryer procesin e shkarkimit të një presidenti të ShBA-së. Çështja më pas kalon në Senat, i cili kontrollohet nga Partia Republikane e Trumpit, që do të thotë se shpallja fajtor dhe largimi nga detyra zor se mund të ndodhë. Nëse Dhoma voton për fajësimin e presidentit, kjo do të ishte hera e tretë në historinë e ShBA-së që një president është përballur me një gjyq të tillë. Dy rastet e tjera përfunduan me shpalljen si të pafajshëm.

NATO-ja përkujton 30-vjetorin e rënies së Murit të Berlinit

BRUKSEL, 6 NËNTOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka nderuar ngjarjet e tri dekadave më parë, që kanë rrëzuar Murin e Berlinit, të cilin e ka konsideruar "plagë në fytyrën e Evropës". "Përmes kullave me armë dhe qenve rojë, muri ka tentuar t'i mbajë njerëzit brenda dhe idetë jashtë. Mirëpo ka dështuar", ka thënë Stoltenberg më 6 nëntor, jashtë selisë së NATO-s në Bruksel, ku është dërguar një

copëz e Murit të Berlinit. "Liria, demokracia dhe dinjiteti njerëzor, të njëjtat vlera që na bashkojnë neve sot, inspiruan njerëzit 30 vjet më parë, për të arritur diçka të jashtëzakonshme", ka thënë shefi i NATO-s. Ambasadori gjerman në NATO, Hans-Dieter Lucas, e ka cilësuar rënien e Murit të Berlinit në nëntor të vitit 1989, "një nga çastet në histori që kanë ndryshuar botën". Më vonë, gjatë ditës, Stoltenbergu

pritet të arrijë në kryeqytetin e Gjermanisë, Berlin, për një vizitë dyditore, gjatë së cilës do ta vizitojë presidentin gjerman Frank-Walter Steinmeier, kancelaren gjermane Angela Merkel dhe zyrtarë të tjerë. Ai, po ashtu, pritët të jetë pjesë e ceremonive përkujtimore për ta shënuar 30-vjetorin e rënies së Murit të Berlinit, si dhe të pranojë një medalje nga Ministria gjermane e Mbrojtjes për kontributin e tij në NATO.



Arta dhe Jeta

Nga: Elife PODVORICA

... dhe tani, të nderuar të pranishëm, në nderim të dëshmorëve të kombit Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, para jush do të jetë sopranoja e re e shumë e suksesshme Arta Jashari.

Ishte ky zëri i ëmbël i Sarandës që sot po udhëhiqte akademinë përkujtimore me rastin e rënies së dy dëshmorëve të kombit Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu.

"UÇK-ja n'borë e n'shi po lufton për liri.

UÇK-ja n'shi e n'borë, po lufton për Kosovë"... ishte zëri i Jonës, i Visarit, i Gentit, i Jetës dhe i Artës të cilët po ia thoshin kësaj kënge me sa fuqi zëri që kishin. Po kush ishin këta ushtarë që po bërtisnin majë malesh së Cerknicsës, një qyteze të vogël që varej mbi shpatullat e maleve alpine në shtetin e Sllovenisë.



Këta ishin fëmijët e tezes Sadete që kishte ardhur në vizitë te mikja e vet e përhershme që nga fëmijëria e tyre e pan-

hareshëm e "burrëror", gjersa po këndonin himnin e UÇK-së me ca shkopinj në krahë që i kishin varur si armë. Ata mbushnin hapësirën e bardhë të maleve të Cerknicsës! Tashmë ata e dinin himnin e UÇK-së, dinin të shkonin edhe në shkollën shqipe, dinin të dilnin edhe në protestat që i organizonin shqiptarët për çlirimin e vendlindjes së prindërve të tyre - Kosovës.

I dëgjonin lajmet dhe e shihnin tmerrin që ndodhte atje! Visari dhe Genti e Jona luanin me ushtarët amerikano-shqiptarë kundër ushtisë serbe, ndërsa

As Arta e as Jeta nuk bëzanin që nënat e tyre i shkëputnin nga lodrat fëmijërore dhe duheshin t'u bashkëngjiteshin grumbullit të madh të protestuesve në Aleksandër Pllac, në Cankarjev Dom, e kudo që mëmat e tyre vraponin për thirrje të atdheut bashkë me shumë e shumë të tjerë.

Nuk bëzanin dhe s'u varej buza në vaj as atëherë kur kalonte vakti i drekës dhe i zinte terri nëpër sheshet ku zhvilloheshin protestat, apo mblidheshin ndihmat në shërbim të ushtarëve të UÇK-së...

...Lulet nuk janë fryma ime.

Legjendat këndoja me mall... ishte zëri i Artës që më shkundi nga këto kujtime të llahtarshme të atyre kohëve të dhimbshme për çdo frymë shqiptare.

... po ne që jemi sot, duhet ta ruajmë me sy shqiptonjash lirinë e çdonjërit prej nesh, rëndësia e të cilit është dëshmuar me gjak nga dëshmorët e kombit tonë, në mesin e të cilëve janë edhe daja im, Afrim Zhitia dhe shoku i përpjekjeve të përbashkëta për çlirimin e këtij vendi, Fahri Fazliu.

- Nuk ka kompromise kur është në pyetje liria e individit, nuk ka kompromise kur është në pyet-

je liria e popullit shqiptar! Këtë na e dëshmuuan daja im Afrim Zhitia dhe miku i tij i idealit, Fahri Fazliu, për të cilët jemi mbledhur sonte këtu të gjithë ne, me rastin e tridhjetëvjetorit të rënies heroike të tyre, që me armë në dorë e dhanë gjakun e tyre për këtë tokë, për tokën ku ka shkelur nëna ime... për tokën ku fëmijërinë e ka pasur edhe daja im, Afrimi.

... kështu po fliste Jeta sot në akademinë përkujtimore të dy dëshmorëve të kombit. Ata nuk ishin diku gjetkë, por këtu midis Prishtinës në atë ditë të 2 nëntorit 1989, në Bregun e Diellit, ku po këndonin himnin e UÇK-së dhe me armë në duar po luftonin një ushtri të tërë të armatës Jugosllave deri në frymën e fundit. Daja Afrim, 24 vjeç, e miku i tij, Fahri, 26 vjeç. As Jeta dhe Arta nuk ishin më majave të maleve alpine, as po e këndonin himnin e UÇK-së. Por, si dy vajza tashme të rritura, shtathedhura e dy bukuroshe syshkruara, po vinin si dy intelektuale të vërteta nga universitete evropiane. Arta nga Lubjana, Berlina e Prishtina, ndërsa Jeta nga Graci, Vjena e Munihu... ato ishin sot në Sallën e Kuqe në Pallatin e Rinisë këtu në Prishtinë dhe me përgjegjësi e emocion të veçantë po flisnin për dajën Afrim para gjithë atyre njerëzve që, nën organizimin e shoqërisë "Lëvizja", ishin tubuar dhe në shenjë respekti e dashurie për këta dy të rinj, po përkujtonin çaste nga jeta dhe aktiviteti i tyre luftarak

Arta me tingujt e vet lirikë e mal-lëngjyes, e Jeta me oratorinë e saj prej një intelektualeje e filozofeje të re, sonte po i thurnin lavdi dajës së tyre, Afrim...



dashme... nuk i kishin ndarë as vitet '90 kur shumë familje shqiptare të Kosovës kishin përjetuar eksodin e shpërnguljes nga vendlindja kah shtetet evropiane. Tezja Sadete ishte degdisur në Gjermani, ndërsa mikja e saj në Slloveni. Pesë vjet nuk kishin arritur të dinin për fatin e njëra-tjetrës. Dhe kur e rigjetën njëra-tjetrën ishin bëra nëna me nga dy-tre fëmijë.

Arta dhe Visari ishin dy fëmijët e mikes së saj të cilët të gëzuar i ishin bashkuar korit të

Arta dhe Jeta lexonin vjersha e këndonin këngë për Kosovën dhe gjyshet e tyre që jetonin aty brenda saj... luteshin që Gresa, Graniti, Flamuri e Dritëroi të shpëtonin nga krahura e zjarrit që kishte pllakosur tërë Jugosllavinë e që pritej ditë ditës edhe Kosovën. E ndiqnin nënën Sadete këmba-këmbës kur ajo thërriste e vraponte natë e ditë për organizimin e të gjithë atyre djemve ushtarë, që përgatiteshin për t'i dalë zot mëmëdheut të tyre.



E rrallë

Prodhoet kamioni që punon me hidrogjen dhe nuk ka nevojë për shofer

Kompania "Hyundai" ka prodhuar një prototip të një kamioni të teknologjisë së fundit, që ecën pa shofer, punon me hidrogjen, por që në formë ngjason me një tren të viteve 1930. Dizajni fantastik e bën mjetin të duket sikur nuk ka dyer por, në fakt, ato janë të rrëshqitshme dhe i japin një pamje tepër të veçantë. Nga marmita e kamionit del vetëm ujë, një gjetje që do të mund të ndryshojë në mënyrë drastike



nivelin e ndotjes së ajrit në rrugët tona. Edhe pse koncepti i kamionit "HDC-6 Neptune" mund të duket futurist, sipas kompanisë koreano-jugore, rrugët e botës do të mbushen me makina të tilla brenda vitit 2030. Pjesa e përparme është frymëzuar nga treni me avull i dizajnuar nga Henry Dreyfuss në Nju Jork në vitet '30 të shekullit të kaluar.

FOTO E DITES



Një burrë me një kovë prek një flakë derisa tymi ngrihet nga zjarri në tregun Balogun në qendër të qytetit Lagos, Nigeri. /AP/

E jashtëzakonshme

WC-ja larë me flori mund të kushtojë 1.2 milion euro

Nëse keni dashur ndonjëherë të dini se sa mund të kushtojë WC-ja e një milioneri në Kinë, përgjigja është rreth 1.2 milion euro. Kjo WC që është prodhuar nga një kompani në Hong Kong është e larë me flori dhe kapaku ka 40 mijë copëza diamanti brenda. Kompania e



luksit që e ka prodhuar quhet "Coronet" dhe është degë e kompanisë së argjendarive në Hong Kong, Aaron Shum. Sipas prodhuesit, kapaku është i bërë me xham antiplumb dhe është stolitur me 40 815 copëza diamanti, që në total shkojnë 334 karat.

BARSOLETA E DITËS



Pasi mbaroi dasma, e shoqëruar me këngë dhe valle, u larguan njerëzit një nga një nga salla. Dhëndri e kapi nusen për dore dhe e pyeti: "Zemër, a u mërzite që e le nënën?" Ajo iu përgjigj: "Më shumë u mërzita që e gjeta tënden!"



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora

14:00

ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj. Regjia: Jill Culton



Çdo ditë në ora 16:00

TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj. Regjia: Josh Cooley



Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj. Regjia: Joachim Ronning



Çdo ditë në ora 22:00

ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.

 <p>DASHI Financat tuaja kanë pasur probleme kohët e fundit. Për këtë arsye keni vendosur t'i shkurtoni shpenzimet.</p>	 <p>DEMI Ka kohë që dashuria nuk ju ka buzëqeshur. Jeni mësuar me këtë fakt dhe sot do të habiteni nga një propozim i papritur.</p>	 <p>BINJAKËT Familja ka marrë masat që sot gjithë koha e shpenzuar të jetë me të. Do të ndiheni i mbushur shpirtërisht.</p>	 <p>GAFORRJA Po e shijoni shumë këtë ditë, edhe pse jeni në vend pune. Keni qetësinë e nevojshme për t'i zgjidhur problemet.</p>	 <p>LUANI Që në orët e para të ditës sot do të merrni një konfirmim që kishit kohë që e prisnit. Kjo do t'ju sjellë shumë humor.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Mëdyshjet që keni lidhur me një person të caktuar sot do t'i shprehni me zë të lartë. Do të shikoni që edhe të tjerët mendojnë si ju.</p>
 <p>PESHORJA Keni diçka për t'i thënë partnerit, por nuk po gjeni çastin e duhur. Rezervoni një udhëtim veç për ju të dy.</p>	 <p>AKREPI Surprizat gjithmonë ju kanë pëlqyer. Një person afër jush e di këtë gjë dhe sot do t'ju japë një emocion të veçantë.</p>	 <p>SHIGJETARI Nuk ndiheni mirë nga gjendja shpirtërore sot dhe do ta reflektoni këtë gjë edhe në humorin tuaj. Do të keni një zënkë me një familjar.</p>	 <p>BRICJAPI Disa probleme të vogla shëndetësore sot ju kanë shqetësuar disi. Duhet të këshilloheni me një mjek.</p>	 <p>UJORI Një person ka hyrë përsëri në jetën tuaj nga e kaluara. Ky fakt nuk po ju shqetëson fare, përkundrazi po e shijoni.</p>	 <p>PESHQIT Edhe pse nuk e pranonin, një problem familjar ju shqetëson prej kohësh. Duhet t'i menaxhoni situatat brenda familjes.</p>

Miley Cyrus heq ish të dashurit nga "Instagram"-i



Miley Cyrus ka hequr ish të dashurin Liam Hemsworth dhe ish të dashurën Kaitlynn Carter nga "Instagram"-i. Nuk dihet saktësisht kur ka ndodhur kjo, por fansat kanë qenë ata që e

kanë vërejtur. As Liam nuk e ndjek këngëtarën, por Kaitlynn vazhdon. Këto lajme vijnë pak orë pasi Kaitlynn foli për lidhjen e saj me Milet. Kaitlynn dhe Miley u ndanë në shtator, pas një romance njëmuajshe.

Anthony Mackie ndahet në heshtje nga gruaja



Anthony Mackie dhe bashkëshortja e tij Sheletta Chapital janë ndarë pasi u martuan në vitin 2014 dhe ishin miq fëmijërie. Aktori 41-vjeçar dorëzoi në

heshtje dokumentet për divorc në vitin 2017 duke mos e ditur askush. Ata kanë katër fëmijë bashkë për të cilët ndajnë kujdestarinë. Nuk dihet ende arsyeja që çoi deri në ndarjen e tyre.




Dua Lipa bën thirrje për sjellje më të mira në rrjetet sociale

Ylli i popit, Dua Lipa, thotë se mediat sociale janë "tokë shumimi për urrejtje dhe ankth". Duke folur për "BBC"-në, ajo u kërkoi përdoruesve të jenë më të mirë ndaj njëri-tjetrit në internet,

për të mirën e përgjithshme. 24-vjeçarja tregoi edhe për veten. "Disa ditë nuk i lexoj komentet. Disa ditë ndoshta ndihem pak më e prekshme dhe pothuajse kërkoj gjëra që nuk dua t'i shoh", ka thënë Dua Lipa.

Drake poston fotografi të djalit



Drake po vazhdon të hapet për jetën me djalit e tij Adonis. Pasi reperi 33-vjeçar ndau një fotografi në festën e ditëlindjen së tij muajin e kaluar, Drake tani ka postuar edhe një, por vetëm këmbën. Atij i shihet njëra çorapë mbi të cilën shkruan: "E dua babin". Drake, i cili e ka fëmijën me yllin e filmave pornografikë Sophie Brussaux, qëndron tejet privat për jetën e të birit. Ai ende nuk ka ndarë një fotografi të plotë të Adonisit.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Feronikeli triumfon ndaj Prishtinës, Ballkani ndalet nga Llapi

Feronikeli ka triumfuar në derbin kryesor të javës së katërbëdhjetë ndaj Prishtinës në "Fadil Vokrri", dhe në këtë mënyrë e ka regjistruar fitoren e dytë në përballje direkte për këtë edicion. Ndërsa liderja e elitës, Ballkani është ndalur në barazim nga Llapi. Fitore kanë regjistruar edhe Drita dhe Drenica në përballjet me Dukagjinin, përkatësisht Trepçën '89



garash është zhvilluar mes dy skuadrave me traditë të madhe në futbollin e Kosovës, Besës dhe Lirisë. Fituese me rezultat minimal doli skuadra pejane, e cila tash renditet e pesta me 21 pikë. Golin e vetëm në këtë ndeshje e realizoi Florim Berbatovci në minutën e 37. Malisheva është befasuar nga 2 Korriku (0-1), kurse Arbëria e mori pozitën e parë pas fitores me rezultat bindës ndaj Trepçës (6-1).

IPKO SUPERLIGA

Ballkani - Llapi	1-1
Drenica - Trepça '89	3-2
Drita - Dukagjini	1-0
Prishtina - Feronikeli	2-3

Të enjten takohen:
13:00 Ferizaj - Flamurtari
13:00 Vushtrria - Gjilani

Tabela

1. Ballkani	14	30 pikë
2. Drita	14	27
3. Gjilani	13	27
4. Prishtina	14	24
5. Llapi	14	24
6. Feronikeli	14	22
7. Drenica	14	20
8. Trepça '89	14	19
9. Flamurtari	13	12
10. Vushtrria	13	9
11. Ferizaj	13	9
12. Dukagjini	14	8

LIGA E PARË

Vllaznia - Drenasi	1-2
Arbëria - Trepça	6-1
KEK-u - Ramiz Sadiku	2-1
Malisheva - 2 Korriku	0-1
Vëllaznimi - Istogu	0-0
Dardana - Ulpiana	0-2
Besa - Liria	1-0

Të enjten takohen:
Vitia - Onix

Tabela

1. Liria	13	22 pikë
2. Malisheva	13	22
3. Arbëria	13	22
4. Istogu	13	21
5. Dardana	13	19
6. Besa	13	18
7. Trepça	13	18
8. Onix	12	16
9. Drenasi	13	16
10. KEK-u	13	16
11. Vllaznia	13	16
12. 2 Korriku	13	13
13. Ulpiana	13	13
14. Ramiz Sadiku	13	11
15. Vitia	12	10
16. Vëllaznimi	13	6

Superligën e Kosovës në futboll. Ndeshja e zhvilluar në Suharekë solli rivalitet të madh, por jo edhe fitues. Ishte skuadra mysafire ajo që shënoi e para në minutën e 33-të për rezultatin 0-1. Autor i golit ishte sulmuesi nga Shqipëria, Sebino Plaku. Vendësit nuk u dorëzuan dhe e gjetën rrugën e golit të barazimit në minutën e 71-të, kurse golashënues ishte Arbër Potoku. Pas kësaj ndeshje skuadra e Ismet Munishit është e para në tabelë me 30 pikë, kurse Llapi është në pozitën e pestë me 24 pikë. Ndeshje interesante është zhvilluar edhe në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, ku fituese ka dalë Drenica në përballje me Trepçën '89 (3-2). Golat e fitores për skuadrën kuqezi i realizuan Arsen Sykaj nga penalltia, Hasan Hyseni dhe Argjend Bardhi, ndërsa për '89-shin shënuan Leart Emini nga penalltia dhe Albert Kaçiku. Një fitore me rezultat minimal 1-0, por shumë të rëndësishme, e arriti skuadra e Dritës në përballje me Dukagjinin. Klubi nga Klina është mbajtur mirë deri në fund të ndeshjes, kurse shënues nga pika e bardhë ishte Izair Emini. Klubi nga Gjilani e ka rrembyer përkohësisht pozitën e dytë me 27 pikë, kurse Dukagjini është në vendin e fundit me 12 pikë.

Besa fiton derbin ndaj Lirisë, Arbëria merr kreun

Janë zhvilluar shtatë nga tetë ndeshjet e javës së trembëdhjetë në Ligën e Parë të Kosovës në futboll. Derbi në këtë rang

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Feronikeli e ka treguar forcën në ndeshjen ndaj Prishtinës në stadiumin "Fadil Vokrri", pasi shënoi fitore në minutat e fundit 2-3. "Nikli" bëri dy herë kthim në rezultat dhe në fund e shënoi edhe golin e tretë që i sjell fitoren e dytë në këtë edicion ndaj kryeqytetasve. Pavarësisht reshjeve të shiut skuadrat u munduan të tregojnë më të mirën nga vetja dhe të arketojnë pikët e plota, gjë të cilën e arriti në fund skuadra nga Drenasi. Tre minuta pasi filloi ndeshja vendasit kaluan në epërsi me golin e sulmuesit Ahmed Januzi, i cili realizoi nga penalltia për rezultatin 1-0. Katër minuta me pas Kastriot Rexha u pengua në zonën e rreptësisë dhe gjyqtari kryesor akordoi penallti, derisa nga pika e bardhë i pagabueshëm ishte Jean Da Silva për rezultatin 1-1. Pjesa e parë përfundoi me këtë rezultat, derisa katër minuta pasi filloi pjesa e dytë Diar Miftaraj e riktheu epërsinë e vendasve 2-1. Një minutë pa u mbushur një orë lojë, kapiteni i skuadrës mysafire, Lapidar Lladrovci realizoi për 2-2. Rastet në minutat në vazhdim nuk munguan, kurse goli që vulosi rezultatin final u shënuan nga Da Silva, në minutën e 88-të. Në derbin tjetër Ballkani është ndalur në barazim nga Llapi (1-1), por e ka ruajtur pozitën e parë në renditjen tabelore në IPKO

SHKURT

FFK-ja zbulon çmimet e biletave për ndeshjen Kosovë - Angli

Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se biletat për ndeshjen kualifikuese për "Euro 2020", Kosovë - Angli, do të dalin në shitje më 12 nëntor, në orën 16:00. Biletat mund të blihen nëpërmjet platformës online www.tiks.app. Çmimet e biletave janë sikurse në ndeshjet e mëparshme për veri dhe jug nga 5 euro, për lindje 10 dhe 15 euro. Për tribunat në Perëndim çmimi do të jetë 15 dhe 20 euro, kurse 80 euro kushtojnë për zonën VIP. Ndeshja do të zhvillohet më 17 nëntor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, në orën 18:00.

Arsenali mendon tas shesë Xhakën

Arsenali është duke konsideruar shitjen e mes-fushorit Granit Xhaka në afatin dimëror. Trajneri Unai Emery ka bërë me dije se Xhakës i është hequr shiriti i kapitenit, derisa në krye të "topçinjve" pritet të jetë sulmuesi Pierre-Emerick Aubameyang. Sipas medieve angleze, shqiptari nuk ka të ardhme në klub. "E ardhmja është e Arsenalit. Kemi ndeshje të rëndësishme të shtunën", ka deklaruar Emery.

Hasani priti drejtuesit e organizatës 'Handicap Students of Kosova'

Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka pritur drejtuesit e organizatës "Handicap Students of Kosova", Leonor Berisha, drejtor ekzekutiv, Edosina Deliu, zëvendës drejtore shë dhe Gentrin Zeqiri, koordinator. Hasani, duke i përgëzuar për punën që po bën kjo organizatë, shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar në aktivitete të përbashkëta sportive. Drejtuesit e kësaj organizate falënderuan kryetarin Hasani për pritjen dhe përkrahjen e ofruar. Gjatë bashkëbisedimit u konstatua se duhet të bëhet më shumë për përshtatjen e infrastrukturës sportive në palestra për personat me aftësi të kufizuara.

Kamberi, gati t'i bashkohet Shqipërisë

Shqipëria po përgatitet për grumbullimin e radhës, ndërkohë që vijon puna edhe me zbulimin e elementëve që mund t'i bashkëngjiten. I tillë është edhe rasti i Florian Kamberit. Sulmuesi 24-vjeçar, i lindur në Cyrih, dhe që ka luajtur katër ndeshje (1 gol) me Kombëtaren U-21 të Zvicrës, po kërkohet me ngulm nga kuqezinjtë. "Sporti në RTV Dukagjini" ka bërë me dije dëshirën e familjareve të lojtarit që ai të bashkohet me Shqipërinë, por duhet të bëhet edhe diçka e fundit nga lojtari. Duke pasur ftesë nga Shqipëria, Kamberi i duhet të formulojë një kërkesë drejt FIFA-s për ndërrimin e Kombëtares. Kjo procedurë do t'i hapte udhë përpilimit të dokumenteve që lojtari të vishej në vijim si kuqezi. Me Hibernian, në 10 ndeshje, këtë sezon, ai ka shënuar një gol.

Llapi: U 'masakruam' nga gjyqtari Gzim Mehmeti

PODUJEVE, 6 NËNTOR - Derbi në mes të Ballkanit dhe Llapit përfundoi 1-1. Pas kësaj ndeshje skuadra nga Podujeva nëpërmjet një postimi në "Facebook" është ankuar se

gjyqtari anësor Gzim Mehmeti e ka dëmtuar skuadrën me anulimin e një goli. "Pamjet në këtë video pasqyrojnë qartë se si gjyqtari anësor, Gzim Mehmeti, e 'masakroi' Llapin

me këtë gol të anuluar. I lartcekuri, pasi sheh që topi hyn në rrjetë pas 20 sekondave, futbollistët dhe stafi në bankinë gëzohen, e anulon golin e pastër, gol që nuk

kishte lidhje me pozitë jashtë loje. Është gjynah se si po humbet mundi i donatorëve dhe djersa e futbollistëve në fushë, kur FFK-ja delegon gjyqtarët e këtij rangu si Gzim Mehmeti me këso tendenca të qarta po na dëmtojnë qëllimisht dhe po na pengojnë në rrugën tonë drejt kreut të tabelës", thuhet në reagimin e skuadrës së Llapit.

'Arena Kombëtare' dhe moszyrtarizimi i UEFA-s ndaj Francës

TIRANË, 6 NËNTOR - Në media sportive ka qarkulluar një lajm në orët e fundit, se UEFA nuk e ka dhënë zyrtarizimin për zhvillimin e takimit në mes të Shqipërisë ndaj Francës në "Arenën Kombëtare". Faktikisht, në

këtë rast është bërë shumë zhurmë për asgjë. Sigurisht se kjo ishte më se e pritshme dhe ka logjikën e saj. Prej muajsh FShF-ja ka njoftuar se konfirmimi i UEFA-s do të vijë në ndeshjen inauguruese të "Arenës Kombëtare".

Bëhet fjalë pikërisht për përballjen në mes të Apolonisë dhe Vllaznisë për femra, atje ku do të thuhet edhe fjala e fundit duke e parë stadiumin delegatët e UEFA-s nga afër. Por kjo fjalë do të jetë tërësisht formale, pasi përballja

me francezët do të luhet pikërisht në kryeqytet. "Nëse shqiptarët shpërndajnë ftesat, atëherë ka gjithmonë dasmë", do të shprehej presidenti i FShF-së, Armand Duka, për të përmbyllur këtë histori.



Krasniqi dhe Bajramaj: Luajmë për fitore ndaj Skocisë

ELBASAN, 6 NËNTOR - Kombëtarja e Shqipërisë për femra, e drejtuar nga trajneri Armir Grima, është duke u stërvitur në qytetin e Elbasanit, në prag të ndeshjes kualifikuese kundër Skocisë e cila do të zhvillohet më datë 8 nëntor, në "Elbasan Arena", në orën 18:10.

Në prag të kësaj ndeshjeje, për të folur për përgatitjet, gjendjen e skuadrës dhe kundërshtarin që kanë përballë, në konferencë kanë dalë Qëndresa Krasniqi dhe Zylfije Bajramaj. Krasniqi ka shfaqur optimizëm përpara ndeshjes me Skocinë. "Kemi ardhur për fitore. Shpresoj ta japim maksimumin për këtë objektiv. Më e rëndësishme është të paraqitemi mirë si ekip dhe uroj që në fund rezultati të jetë i mirë. Arma më e fortë është se jemi të gjithë të bashkuara. Jemi një grup shumë i mirë dhe besoj se kjo do të na ndihmojë shumë që të paraqitemi mirë në fushë.



Shpresoj të ketë një numër të madh të tifozëve, pasi na ndihmon shumë të luajmë mirë, na motivojnë", ka thënë Krasniqi. Ndërsa Zylfije Bajramaj ka deklaruar: "Harmonia është e mirë dhe besoj se do të kemi rezultat të mirë këtë ndeshje. Gjithmonë jemi të bashkuara. Normalisht që ne kemi ardhur

për fitore dhe duam tri pikët, por edhe me një barazim do të ishim të kënaqura. Pritshmëritë për kombëtaren e femrave? Besoj se në një të ardhme do të kemi një emër dhe do të hyjmë në elitën ndërkombëtare. Besoj se do të bëjmë emër si ekipet e mëdha".

Lakersat të pandalshëm, Bostoni regjistron fitoren e pestë

CHICAGO, 6 NËNTOR - LeBron Jamesi bëri dallimin mbi parket në fitoren me përmbysje të Los Angeles Lakersit 112-118 në fushën e Chicago Bullsit, duke realizuar "triple doubten" e radhës: 30 pikë, 11 asistime dhe 10 rikuperime në 35 minuta lojë. Kalifornianët e bënë dallimin në periodën e fundit me një rezultat të pjesshëm 18-38, që ua dha mundësinë ta festojnë suksesin e gjashtë sezonal. Lakersi është i vetmi në Konferencën e Perëndimit me vetëm një humbje në këtë fillim sezoni. Vijon rezultati pozitiv edhe për Boston Celticsin, që siguroi fitoren e pestë radhazi, pasi mposhti Cleveland Cavaliersin me rezultatin 119-113 falë paraqitjes mbresëlënëse të Gordon Haywardit, që barazon rekordin personal me 39 pikë të shënuara me fanellën e Celticsit. Fitore e lehtë për Denver Nuggetsin, që e mbylli takimin me Miami Heatin me 20 pikë dallim, 109-89. Shënuesi më i mirë rezultoi Jamal Murray me 21 pikë, por shumë i rëndësishëm ishte edhe "double double" i Will Bartonit (15 pikë dhe 10 "rebounde"). Vjen fitorja e



tretë radhazi për Charlotte Hornetsin, që fitoi pas kohës shtesë 122-120 ndaj Indiana Pacersit. Vendimtar në këtë sukses të skuadrës, që është në pronësi të Michael Jordanit, Devonte Graham, autor i 35 pikëve. Për Pacersin rezultuan të pamjaftueshme 33 pikët e TJ Warrenit dhe 31 të Malcolm Brogdonit. Oklahoma City Thunderi fitoi ndaj Orlando Magicut për 102-94 falë 24 pikëve të Shai Gilgeous-Alexander dhe 20 të Chris Paulit. Krizë rezultatesh për Magicin, i cili pësoi humbjen e tretë radhazi.

Pësoi humbjen e dytë radhazi San Antonio Spursi, që këtë radhë u dorëzua në parketin e Atlanta Hawksit 108-100. Vendimtar rezultati i periodës së fundit (38-22) në favor të Hawksit, i udhëhequr nga Trae Youngm, autor i 29 pikëve dhe i 13 asistimeve.

REZULTATET

Charlotte Hornets - Indiana Pacers	122-120
Cleveland Cavaliers - Boston Celtics	113-119
Atlanta Hawks - San Antonio Spurs	108-100
Chicago Bulls - Los Angeles Lakers	112-118
Oklahoma City Thunder - Orlando Magic	102-94
Denver Nuggets - Miami Heat	109-89

SHKURT

Honda transferohet te Vitesse

Keisuke Honda është transferuar edhe zyrtarisht te Vitesse. Mesfushori japonez është transferuar te klubi holandez si lojtar i lirë. Ai kishte luajtur te VVV-Venlo. Honda ka nënshkruar kontratë me Vitesse deri në fund të këtij sezoni me mundësi vazhdimi. "Ka kaluar një kohë e gjatë që kur kam luajtur në Holandë. Shpresoj që tifozët në Holandë të më kujtojnë ende. Do të bëj gjithçka që t'i impresionoj tifozët", ka thënë Honda. "Dua të jem i rëndësishëm për skuadrën, të luaj në stadium dhe të luaj për tifozët. Është një ndjenjë e mirë që pasi luajta për VVV-Venlo, ta veshi sërisht fanellën verdhe e zi", ka shtuar Honda.

Reali ofron Jamesin për Aubameyangut

Sulmuesi Pierre-Emerick Aubameyang është duke kaluar një formë të mirë dhe deri më tani ka realizuar tetë gola, duke u kthyer në golashënuesin më të mirë të ekipit. Sipas "El Desmarque", nëse Arsenali nuk do të kualifikohet edhe këtë sezon në Ligën e Kampionëve, Real Madridi është i gatshëm për t'u futur në garë për sulmuesin nga Gaboni. Ekipi mbretëror është në kërkim të një sulmuesi të shpejtë dhe të shënojë shumë gola dhe profili i Aubameyangut shikohet si i duhuri për ta përforcuar repartin e sulmit. Një hipotezë për formulën e transferimit është edhe ajo e shkëmbimit ndërmjet tij dhe James Rodriguezit.

Lokomotiva vendos ta blejë kartonin e Marios

Lokomotiva e Moskës ka vendosur ta blejë kartonin e Joao Marios, i cili u huazua tek ekipi i drejtuar nga Yuri Semin gjatë afatit kalimtar të verës. Mesfushori është përshtatur plotësisht me ambientin duke bindur drejtuesit e Lokomotivës të ushtrojnë të drejtën e blerjes përfundimtare të kartonit të tij. Nga shitja e 26-vjeçarit, i cili u shpall nga tifozët dhe mediet si lojtari më i mirë i muajit tetor, zikaltrit do ta përfitojnë shumën e 18 milionë eurove, para të cilat do t'i investojnë më pas në merkato.

Hummels: Në pushim biseduam si ta përmbysin rezultatin

Kapiteni i Borussia Dortmundit, Mats Hummels, ka treguar se si arriti skuadra gjermane ta përmbysë rezultatin nga 0-2 në 3-2 në ndeshjen ndaj Interit në Ligën e Kampionëve. Mbrojtësi gjerman bëri me dije se në dhomat e zhveshjes folën për mënyrën se si mund ta përmbysin rezultatin që në fund e arritën me sukses. "Interi ishte vrasës në kundërsulm dhe na shënoi dy gola me vetëm dy goditje. Ne nuk e bëmë këtë gjë në pjesën e parë. U lamë shumë hapësira sa duhet, por në pjesën e dytë bëmë një ndeshje vërtet të shkëlqyer dhe fantastike. Folëm me njëri-tjetrin në pushim dhe thamë se duhet të vazhdonim të luanim siç kishim bërë më parë me topin, por duhet të krijonim më shumë raste për t'i shndërruar në gol. E dija që do të bënim një ndeshje të mirë dhe jam krenar për skuadrën", ka thënë Hummelsi.

Conte i zhgënjyer pas humbjes nga Dortmundi

Trajneri i Interit, Antonio Conte, është i mërzhitur për humbjen që skuadra e tij e pësoi nga Borussia Dortmundi (3-2). "Ishte e njëjta gjë që na ndodhi ndaj Barcelonës. Në fakt, ishte më e keqe, sepse kishim avantazh të dyfishtë. Jam i zhgënjyer por, çfarë të them? Nuk më bëhet fare të flas për pjesën e dytë pasi ka shumë alibi dhe nuk dua të krijoj më tepër. Djemtë vetëm mund t'i falënderoj sepse dhanë gjithçka në një periudhë ku kemi pasur shumë ndeshje. Nuk më intereson për janarin apo shkurtin. Duhet ta kishim planifikuar më mirë këtë sezon. Kemi vërtetuar se mund të mposhtim këdo nëse jemi në formë", ka thënë Conte. "Më duhet të flas me lojtarët sepse me Sassuolon ishim 4-1 dhe ndeshja përfundoi 4-3. Ne jemi Interi, kështu që duhet ta shohim veten tonë dhe të kuptojmë se kush jemi. Jam shumë i mërzhitur sepse nuk mund të bëjmë më shumë se kjo. Kemi kapur limitin tonë", ka deklaruar Conte.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Dy Dëshmorët"
Komuna: Lipjan
Data: 07.11.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/041-CS/1.4	Sigurimi i cilësisë në shkolla

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkollës "Dy Dëshmorët" Dobrajë e Madhe, Lipjan. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Sigurimi i cilësisë në shkolla

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë. Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e sigurimit të cilësisë në shkolla;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e njëjtë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

